



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.07.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të komisionit datë 08.07.2016
2. Diskutimi në parim dhe shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
3. Diskutimi në parim dhe shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Mucmata, Petrit Vasili.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

John Smibert – ekspert i Nivelit të Lartë, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Artan Hoxha, ekspert i Nivelit të Lartë

Arben Rakipi, ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Meqenëse formohet kuorumi, mund të fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi.

Në rendin e ditës kemi dy: projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Fillimisht do të shqyrtojmë projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë. Do të dëgjojmë relatorin për vlerësimin rreth këtij projektligjit, pasi kemi bërë një seancë prezantimi, janë bërë pyetje nga relatori dhe nga deputetët për grupin e ekspertëve që ka punuar me këtë projektligj, pasi janë dëgjuar përgjigjet e pyetjeve, komentet dhe sugjerimet e bëra. Relatori do të japë një vlerësim në parim dhe më pas do të fillojmë me shqyrtimin e projektligjit nen për nen.

Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi.

Sot do të bëj një relativ të përmbledhur të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj është përgatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, që funksionon pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi, dhe është hartuar për të vënë në zbatim ndryshimet kushtetuese, që janë hartuar në bazë të neneve 148 dhe 149/“ç” të këtyre ndryshimeve kushtetuese.

Nga analiza e nenit 81, pika 2 e Kushtetutës dhe e përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në germën “a” pika 2, të neni 81 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Është një projektligj i ri dhe ka për qëllim të përshtasë organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë në përcaktimin e ri kushtetues; është produkt i ekspertizës së dhënë nga ekspertët e nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtarë. Ky projektligj synon të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, kushtet dhe procedurën për emërimin e prokurorit të Përgjithshëm, marrëdhëniet e prokurorisë me institucionet e tjera shtetërore, me subjektet e tjera publike ose private dhe me publikun.

Ligji nuk rregullon çështjet e statusit, të karrierës, të disiplinimit dhe të etikës së prokurorëve, të cilat, siç jemi në dijeni, trajtohen nga projektligji i posaçëm mbi statusin e magjistratëve, gjyqtarë dhe prokurorë, në Republikën e Shqipërisë, bazuar edhe në rekomandimin e dokumentit analitik për parashikimin e të njëjtit regjim për zgjedhje, përgjegjshmëri dhe disiplinë, si për prokurorët, ashtu edhe për gjyqtarët.

Projektligji përbëhet nga 78 nene dhe është strukturuar në 9 krerë, të përbërë nga seksione. Pse lindi nevoja për hartimin e këtij projektligji? Dokumenti analitik mbi sistemin e drejtësisë evidentoi një sërë problemesh të rëndësishme për sa i përket organizimit dhe funksionimit të prokurorisë në Shqipëri ndër të cilat më kryesoret janë:

Së pari, politizimi i procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të prokurorit të Përgjithshëm, si pasojë e mungesës së kriterëve dhe procedurave të detajuara të përzgjedhjes të tilla që të garantojnë konkurrimin e hapur, transparent dhe vlerësimin mbi baza objektive të kandidatëve.

Së dyti, mungesa e pavarësisë funksionale të prokurorëve gjatë hetimeve paraprake, si rezultat i centralizimit të thellë të sistemit aktual që i njeh kompetenca të gjera prokurorëve më të lartë dhe prokurorit të Përgjithshëm në veçanti mbi hetimet e kryera nga prokurorët më të ulët.

Së treti, kishte paqartësi në organizimin hierarkik, lëndor dhe territorial të prokurorisë, si dhe në marrëdhëniet prokurori-Polici Gjyqësore, të cilat janë bërë shkas për mungesën e eficiencës së punës së prokurorisë, mungesën e hetimeve proaktive, shpeshherë edhe pushimin e pajustificuar të procedimeve penale në hetimet paraprake.

Së katërti, mungesa e përfshirjes së një organi të pavarur vetëqeverisës, si Këshilli i Prokurorisë në procesin e përzgjedhjes, karrierës dhe disiplinimit të prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorëve të tjerë të sistemit.

Për zgjidhjen e problematikave të mësipërme planveprimi i reformës në sistemin e drejtësisë e pa të nevojshëm hartimin e një ligji të ri, që të ketë në përmbajtjen e tij një sërë ndryshimesh ligjore krahasuar me ligjin organik ekzistues “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, me qëllimin kryesor garantimin e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve; rishikimin e kompetencave të hetimit dhe të përfaqësimit të akuzës në gjykatë, duke nxitur kontrollin efektiv dhe balancimin e këtyre kompetencave nga strukturat përgjegjëse, sigurimin e pavarësisë së mjaftueshme të strukturave të veçanta të prokurorisë, vendosjen e rregullave të qarta për disiplinimin e autoritetit të prokurorëve më të lartë në raport me prokurorët e çështjes, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe të pavarësisë në veprimtarinë e tyre.

Dy fjalë për procesin dhe metodologjinë e përdorur.

Përgatitja e projektligjit “Për funksionimin dhe organizimin e prokurorisë” ka nisur në tetor të vitit 2015, me mbledhjet e përbashkëta të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë dhe sekretariatit teknik të Kuvendit. Me përfundimin e strukturës dhe draftit të parë të projektligjit në muajin nëntor të vitit 2015, projektligji iu nënshtrua për mendim grupit *thing teng* të drejtësisë penale, i cili ka në përbërje të tij prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe nga prokuroritë e rretheve, të cilët kanë marrë pjesë rregullisht me ekspertizën e tyre në këtë grup, kuptohet edhe me prezencën e ekspertëve të opozitës. Sugjerimet dhe propozimet e bëra në këto takime nga prokurorët, ekspertët e opozitës, Ministria e Drejtësisë, si dhe institucione të tjera publike kanë gjetur pasqyrim në krerë të caktuar të projektligjit.

Projektligji është bazuar në standardet ndërkombëtare të organizimit dhe funksionimit të organit të prokurorisë, ka marrë për bazë rregullimin aktual ligjor si dhe modelet e vendeve të tjera, të cilat janë përfshirë për reforma të tilla për mirëfunksionimin, rritjen e eficiencës dhe pavarësisë së organit të prokurorisë. Deri në maj të vitit 2016 grupi i ekspertëve të drejtësisë penale ka punuar ngushtësisht me ekspertët e misioneve EURALIUS dhe OPDAT për harmonizimin final të projektligjit “Për prokurorinë” me projektligjet e tjera, që kanë qenë në proces hartimi nga grupet e punës.

Në muajin maj ky grup pune ka zhvilluar mbledhje dhe konsultime publike me prokurorë, gjyqtarë dhe aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë penale në vend, për të prezantuar dhe marrë komente mbi draftin përfundimtar të projektligjit “Për prokurorinë”.

Vlen të theksohet se pas miratimit ose pas prezantimit në parim të projektligjit “Për prokurorinë” në këtë komision të nderuar të reformës në drejtësi, edhe nga ana e komisionit gjatë kësaj kohe, deri në fillimin e diskutimit dhe miratimit nen për nen të këtij ligji, edhe nëpërmjet sekretariatit teknik të Kuvendit, u është bërë thirrje përsëri prokurorëve, gjyqtarëve, komunitetit të gjerë të aktorëve të sistemit të drejtësisë penale në vend që të bëhen pjesë, me sugjerimet dhe komentet e tyre, sepse jemi ende në fazën ku sugjerime dhe komente me vlerë mund të bëhen pjesë e këtij projektligji.

Cilat janë përparësitë e projektligjit? Bazuar në problematikat e evidentuara dhe të analizuara në dokumentin e analizës së sistemit në drejtësisë, ky projektligj parashikohet të ketë këto përparësi dhe efekte të pritshme:

Së pari, parashikimin e ndryshimeve ligjore krahasuar me ligjin organik ekzistues “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, me qëllim garantimin e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve.

Së dyti, rishikimin e kompetencave të hetimit dhe të përfaqësimit të akuzës në gjykatë, duke nxitur kontrollin efektiv dhe balancimin e këtyre kompetencave nga strukturat përgjegjëse .

Së treti, siguron pavarësinë e mjaftueshme të strukturave të veçanta të prokurorisë, vendosjen e rregullave të qarta për disiplinimin e autoritetit të prokurorëve më të lartë në raport me prokurorët e çështjes, duke respektuar parimet e ligjshmërisë dhe pavarësisë së veprimtarisë së tyre.

Risite kryesore të këtij projektligji do t'i përmbledhja shkurtimisht: rregullimet ligjore që propozon me këtë projektligj ka të bëjnë kryesisht me një çështje shumë thelbësore. Ky ligj ka si risi kryesore decentralizimin e sistemit të prokurorisë. Bazuar në amendamentet kushtetuese, të miratuara nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi, prokuroria nuk do të jetë më organ i centralizuar dhe thellësisht hierarkik. Projekti kushtetues garanton mbarëvajtjen e organit të prokurorisë dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve si në ushtrimin e ndjekjes penale, ashtu edhe në përfaqësimin e akuzës në gjyq.

Për sa më sipër, projektligji ka rishikuar mënyrën e organizimit të brendshëm të sistemit, gjithmonë në funksion të garantimit të kësaj pavarësie funksionale të prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete. Natyrisht, projektligji është kujdesur për të siguruar qëndrueshmërinë e organit të prokurorisë dhe uniformitetin e veprimtarisë së saj. Në këtë projektligj kjo garantohej nëpërmjet mundësisë së nxjerrjes së udhëzimeve të karakterit të përgjithshëm nga prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesit e prokurorive, të cilët kanë përgjegjësi ligjore për mbarëvajtjen e punës në prokurori, si dhe dhënies së udhëzimeve jo të detyrueshme lidhur me çështje konkrete.

Në projektligj përcaktohet shprehimisht se prokurori është përgjegjës për çështjen që i ngarkohet dhe i pavarur në punën e tij, me detyrimin që në çdo rast të ndjekë udhëzimet e natyrës së përgjithshme të prokurorëve më të lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, bazuar edhe në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftë kundër kriminalitetit.

Gjithashtu, në projektligj përcaktohen rregulla të qarta, që disjplinojnë autoritetin e drejtuesit të prokurorisë, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe të pavarësisë në ushtrimin e funksionit të prokurorit, si: procedura që duhet ndjekur nga prokurori më i lartë për nxjerrjen e udhëzimeve, rastet dhe mënyra e refuzimit të zbatimit të tyre nga prokurorët e çështjes. Pra, është disiplinuar në projektligj kjo natyrë e bashkëpunimit ndërmjet prokurorit më të lartë dhe prokurorëve të hetimit.

Së dyti, ligji ka normuar marrëdhëniet mes prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorive pranë gjykatave në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë si dhe është qartësuar procedura e heqjes dorë ose e tërheqjes së një çështje nga prokurori titullar në rastet e mosveprimit apo të paaftësisë për të kryer veprimet hetimore brenda afateve ligjore të normuara në Kodin e Procedurës Penale.

(Ndërhyrje në anglisht.)

...do të balancohet nga raporte që vendosen me drejtuesin e prokurorisë, duke bërë të mundur evitimin e abuzimeve apo të gabimeve nëpërmjet udhëzimeve detyruese të prokurorit më të lartë, informimit të drejtuesit të prokurorisë mbi ecurinë e çështjes apo tërheqja e çështjes në rast mosveprimit apo tejkalimi afatesh. Është theksuar qartazi edhe nga grupi ekspertëve, por edhe nga ekspertët që sot janë të pranishëm në këtë sallë, që kjo veprimtari e prokurorisë duhet të shoqërohet domosdoshmërisht edhe me kontrollin gjyqësor të dosjes hetimore nga gjyqtari i veprimeve paraprahe. Lidhur me përfshirjen e kësaj figure të re në procesin penal është i nevojshëm amendimi i Kodit të Procedurës Penale. Në projektin e ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, kjo figurë e procesit penal nuk është parashikuar. Ndërkohë, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, bazuar në ndryshimet thelbësore që i bëhen funksionimit të organit të prokurorisë, rritjes së pavarësisë së prokurorit në fazën e hetimeve paraprahe, si dhe problemeve të rënda që has aktualisht procesi penal në fazën e hetimeve paraprahe, mbështet fort mendimin se kjo figurë është e domosdoshme për garantimin e ligjshmërisë dhe të vetë gjykimit. Natyrisht, këtij mendimi të ekspertëve të lartë i bashkëngjitem edhe unë, në cilësinë e relatorit të këtij projektligji, sepse kontrolli gjyqësor mbi hetimet paraprahe do të ishte një garanci shtesë mbi procesin e ligjshmërisë, të pavarësisë dhe të paanësisë në hetimet paraprahe në kushtet e këtij decentralizimi kushtetues të organit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Risia e dytë është ngritja e Prokurorisë së Posaçme dhe e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Amendamentet Kushtetuese parashikojnë ngritjen e Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilat bashkërisht quhen strukturë e posaçme dhe përbëjnë atë që quhet Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si struktura të pavarura dhe të specializuara në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Synimi ka qenë që nëpërmjet këtyre strukturave të krijohen kushtet për hetimin dhe ndjekjen në mënyrë efektive të çështjeve komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ligji parashikon se pjesë e strukturës së prokurorisë do të jetë edhe Prokuroria e Posaçme, duke specifikuar që organizimi dhe funksionimi i kësaj strukture do të bëhet me ligj të veçantë edhe për shkak se ndryshimet kushtetuese e kanë ngritur në nivelin e një organi

kushtetues brenda strukturës së prokurorisë. Ligji i veçantë që tashmë është pjesë paketës që po diskutohet në këtë komision, ka parashikuar në mënyrë të hollësishme, rregullimin dhe funksionimin e Njësisë së Posaçme Hetimore e quajtur në vazhdim Byroja Kombëtare e Hetimit, që do të funksionojë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Vlen të theksohet që Prokuroria e Posaçme do t'u nënshtrohet rregullimeve të këtij ligji që po diskutojmë sot për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e saj posaçëm.

Risia e tretë e këtij projektligji është përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm.

Ky projektligj përcakton kushtet ligjore dhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për prokuror të Përgjithshëm, me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për të garantuar pavarësinë dhe rritjen e besimit të publikut në institucionin e prokurorisë. Dispozitat ligjore parashikojnë një proces të hapur, transparent për përzgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në kriterë objektive dhe të meritokracisë, si: kualifikimi, integriteti moral dhe profesional, aftësitë profesionale dhe pastërtia e figurës së kandidatit.

Së katërti, si risi vjen edhe ngritja e seksioneve të specializuara në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë. Ngritja e këtyre seksioneve synon specializimin e prokurorëve dhe do të ketë në përbërje ekspertë të fushave respektive dhe mjetet e nevojshme teknologjike për të garantuar cilësinë e hetimeve.

Risi tjetër është shpërndarja e çështjeve në mënyrë të paanshme. Deri më tani shpërndarja e çështjeve ka qenë tërësisht në duart e drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë, i cili kishte edhe përgjegjësinë për të siguruar njëfarë balance në volumin dhe ngarkesën e punës së prokurorëve, gjithsesi nuk bazohej në kriterë. Me anë të këtij projektligji janë përcaktuar rregulla të detajuara për të siguruar që shpërndarja e çështjeve të prokurorëve të kryhet në atë mënyrë që të përmbushë kërkesat për paanshmëri dhe objektivitet, duke marrë njëkohësisht në konsideratë edhe nevojën për maksimizimin e eficiencës së veprimtarisë në punën e prokurorisë.

Vlen të përmendet si risi edhe roli vendimmarrës i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për çështjet e statusit dhe të karrierës së prokurorëve dhe kjo është risia themelore. Tashmë, bazuar në nenin 149 të amendimeve kushtetuese, përcaktohet qartë se Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të jetë autoriteti që do të garantojë pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në linjë me këtë parapërcaktim kushtetues, projektligji parashikon një rol të rëndësishëm të këshillit në përzgjedhjen dhe propozimin e kandidaturave për prokuror të Përgjithshëm, si dhe në garantimin e rregullshmërisë së procesit të përzgjedhjes së tij.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e parashikuara nga projektligji janë si më poshtë:

Projektligji, duke iu referuar strukturës, do të ketë nëntë krerë. Në kreun e parë dhe të dytë janë përcaktuar objekti dhe parimet mbi të cilat bazohet organizimi dhe funksionimi i prokurorisë.

Në kreun e tretë është bërë rregullimi organizativ dhe strukturor i prokurorisë. Këtu ka dy elemente të rëndësishme që propozohen në ndryshim nga rregullimi i mëparshëm: parashikimi i degëve të prokurorive pranë degëve të gjykatave dhe krijimi i seksioneve të prokurorisë duke marrë në konsideratë mënyrën e ngritjes së tyre dhe specializimin e prokurorëve dhe të Policisë Gjyqësore në luftën kundër kriminalitetit.

Në kreun e katërt janë përcaktuar rregulla të rëndësishme për sa u përket kushteve ligjore, kriterëve të vlerësimit dhe procedurës së përzgjedhjes së prokurorit të Përgjithshëm. Është reflektuar neni 148/a i Kushtetutës, ku janë parashikuar kushtet ligjore për emërimin e prokurorit të Përgjithshëm. Brenda kornizës kushtetuese, projektligji përcakton kriteret për vlerësimin e kandidatëve. Për këtë propozohet një dispozitë e përgjithshme, kuptimi i së cilës është i detajuar në dispozita të veçanta dhe u referohet kategorive përkatëse.

Kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm kanë të bëjnë me vlerësimin profesional, me integritetin moral dhe profesional dhe me aftësitë organizative, drejtuese dhe menaxheriale. Janë përcaktuar gjithashtu edhe kriteret e tjera shtesë, por rregullat e detajuara për mënyrën dhe procedurën e vlerësimit të kandidatëve për prokuror të Përgjithshëm do të përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kryesisht në drejtim të rregullimit funksional të procesit të verifikimit të kandidatëve.

Në seksionin e dytë të këtij kreu parashikohet procedura e detajuar për përzgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm, që nga thirrja për aplikim, verifikimi i kandidaturave fillimisht në komisionin e karrierës ose të emërimeve në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe deri në vendimmarrjen e këshillit. Në këtë procedurë vlen të theksohet se janë parashikuar afate kohore të detyrueshme, si edhe e drejta për ankimim e kandidatëve sipas fazave të përzgjedhjes.

Ka një rregullim të posaçëm lidhur me kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm për të garantuar unifikimin e organit të prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, nëpërmjet nxjerrjes së udhëzimeve me karakter të përgjithshëm, dhe drejtimin e administratës së prokurorisë. Për herë të parë parashikohet figura e zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, i cili emërohet nga prokurori i Përgjithshëm dhe e ushtron funksionin në mënyrë të përkohshme, në mungesë të këtij të fundit, me qëllim garantimin e vazhdimin të veprimtarisë së organit.

Në kreun e pestë përcaktohen funksionet e drejtuesit të prokurorisë në kuadër të drejtimit të prokurorisë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm. Në mënyrë të ngjashme me zëvendësprokurorin e Përgjithshëm është parashikuar edhe figura e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë së nivelit të parë, i cili emërohet nga drejtuesi dhe i ushtron funksionet në mungesë të këtij të fundit. Pra, është ruajtur njëfarë hierarkie në organizimin dhe strukturën e organit të prokurorisë.

Kreu i gjashtë është kre i rëndësishëm, pasi rregullon marrëdhëniet e prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të prokurorisë me prokurorët më të ulët. Në mënyrë të veçantë rregullimi i marrëdhënieve udhëhiqet nga parimi i pavarësisë funksionale të prokurorëve paralelisht me nevojën e ruajtjes së qëndrueshmërisë së strukturës nëpërmjet udhëzimeve me karakter të përgjithshëm, por edhe udhëzimeve jodetyruese për procedime penale konkrete.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe përcaktimin e linjave të veprimtarisë së prokurorisë, projekti propozon krijimin e organeve kolegjiale, mbledhjen e prokurorëve me kompetenca këshillimore dhe vendimmarrëse për çështje që lidhen me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë.

Vlen të theksohet në këtë pikë, gjë që do ta diskutojmë edhe nen për nen, se duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme që funksionimi i këtij organi kolegjial nuk duhet të konfundohet me mbledhjen e prokurorëve të Shqipërisë ose të të gjitha prokurorive, sepse mbledhje e prokurorisë që funksionon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në secilën nga prokuroritë e organizuara pranë sistemit. Pra, nuk kemi të bëjmë me mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve nga e cila me ligjin ekzistues buronte si organ kolegjial Këshilli i Prokurorisë, i cili me ligjin aktual ka thjesht kompetenca këshillimore.

Në kreun e shtatë janë parashikuar rregullat për administratën e prokurorisë, duke parashikuar edhe punonjësit që do të bëjnë strukturën e prokurorive pranë gjykatave dhe strukturën e administratës në Prokurorinë e Përgjithshme. Element i rëndësishëm i propozuar në projektligj është zëvendësimi i ndihmësveligjorë me prokurorët e komanduar, të cilët do të kryejnë funksione në ndihmë të prokurorëve dhe që kanë rregullim të posaçëm në ligjin “Për statusin e magjistratëve”, si dhe ngritja e seksioneve brenda strukturave të prokurorisë.

Në kreun e tetë përcaktohen marrëdhëniet e prokurorisë me institucionet e tjera. Konkretisht, parashikohet bashkëpunimi me Këshillin e Ministrave, për sa u përket rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, të cilat zhvillohen si udhëzime të përgjithshme të prokurorit të Përgjithshëm. Një parashikim i rëndësishëm ligjor është ai që rregullon marrëdhëniet e prokurorisë me Këshillin e Ministrave dhe me Kuvendin për sa i

përket buxhetit të prokurorisë, me qëllim garantimin e pavarësisë buxhetore dhe marrjen në konsideratë të nevojës së organit të prokurorisë për fonde publike.

Në tërësi ligji synon që nëpërmjet rregullimeve të reja të harmonizohet me standardet ndërkombëtare të funksionimit të prokurorisë. Në vazhdim të përvojës së fituar dhe të problematikave të evidentuara në sistemin aktual, të bëjë të mundur ofrimin e baze ligjore të përshtatshme për të ndikuar në rritjen e integritetit, pavarësisë dhe eficiencës së organit të prokurorisë. Projektligji nëpërmjet një dispozite kalimtare, në përputhje me parashikimet e nenit 169 të projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, parashikon se prokurorët dhe ndihmësitligjorë në detyrë u nënshtrohen dispozitave të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Gjithashtu, nëpunësit civilë në detyrë dhe punonjësit në prokurori konsiderohen nëpunës civilë në përputhje me këtë ligj. Projektligji parashikon shfuqizimin e ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Sigurisht që unë, së bashku me kolegët e komisionit, në diskutimin nen për nen do të jemi të hapur për komente, pyetje dhe propozime për riformulime të neneve të caktuara, pasi mendojmë se kjo do të jetë një vlerë e shtuar për këtë projektligj kaq të rëndësishëm, i cili ka të bëjë me një nga agjencitë ligjzbatuese më të rëndësishme në vend, që është institucioni i akuzës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja, që në cilësinë e relatorit të këtij projektligji, bëtë një analizë shtjelluese, një ekspozitë të të gjitha aspekteve themelore të këtij projekti, të qëllimeve, të risive dhe të pritshmërive që ofron ky projektligj, si ndër më të rëndësishmit e paktës ligjore për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri!

Ky është një projektligj i rëndësishëm për shkak se synon të reformojë bazuar në analizën e kryer lidhur me gjendjen e deritanishme të sistemit të prokurorisë, që është institucioni më i rëndësishëm në sistemin e drejtësisë penale, duke sjellë një sërë risish, të cilat kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në nivel qendror dhe në nivel vendor në sensin e prokurorive pranë gjykatave.

Në vlerësimin tim, projektligji ka arritur të zgjidhë një sërë çështjesh të rëndësishme, një sërë problematikash, që ndeshen sot në funksionimin e sistemit të prokurorisë; ka arritur t’u japë përgjigje disa çështjeve të trajtuara edhe gjatë debatit që është zhvilluar lidhur me këtë projektligj. Është bërë një debat i gjerë, me muaj të tërë, dhe shkak ka qenë jo vetëm diskutimi i projektit kushtetues dhe i amendamenteve, që kanë të bëjnë me formimin e sistemit të drejtësisë penale, që ndoshta janë ndër pjesët më të rëndësishme të projektit

kushtetues, por edhe projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” iu nënshtrua një konsultimi të gjerë publik përmes tryezave tematike të zhvilluara në Tiranë dhe në rajone të ndryshme të vendit, me prokurorë të thjeshtë, me prokurorët pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, gjithashtu, edhe me prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Gjithashtu, në këto konsulta, përveç prokurorëve, kanë marrë pjesë edhe oficerë të Policisë Gjyqësore, pedagogë të fushës së drejtësisë penale, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Kontributet e tyre në këtë proces kanë qenë shumë të vlerësuara dhe konstatoj me kënaqësi se një pjesë e tyre janë marrë në konsideratë nga grupi i ekspertëve që ka punuar me këtë projektligj.

Gjithashtu, siç tha me të drejtë relatori, pavarësisht njohjes që kanë pasur në të gjitha fazat e zhvillimit të këtij projektligji, gjatë gjithë kësaj periudhe që ky projektligj ishte depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në versionin përfundimtar të grupit të ekspertëve, ne u kemi dërguar të gjithë prokurorëve të Republikës së Shqipërisë me email tekstin e depozituar të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, me ftesën për t’u njohur me versionin përfundimtar, për të parë se çfarë është marrë në konsideratë nga i gjithë procesi i konsultimit lidhur me komentet, sugjerimet e tyre për të dhënë vlerësime, komente dhe sugjerime të tjera, nëse do ta çmonin të arsyeshme. Një pjesë e tyre janë përgjigjur pozitivisht, siç e prezantoi edhe relatori, i cili është munduar t’i thjeshtojë në diskutimin nen për nen.

Është momenti për të vlerësuar punën shumë të mirë për hartimin e këtij projektligji të bërë nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, nën drejtimin e dy bashkëdrejtuesve të grupit të drejtësisë penale, profesorit Artan Hoxha dhe zotit Jon Smibert, përfaqësues i misionit OPDAT i Departamentit të Drejtësisë së SHBA-ve. Gjithashtu, duhet vlerësuar puna e zonjës Bumçi, zotit Rakipi, përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme, personave të nominuar nga prokurori i Përgjithshëm i Republikës në përbërje të këtij grupi pune, dy prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, zotit Reshka dhe zotit Ligori, si dhe pjesa e sekretariatit teknik, që ka kontribuar me një përkushtim të veçantë në mbështetje të punës së ekspertëve të nivelit të lartë, natyrisht edhe të gjithë ata që, me sugjerimet dhe vlerësimet, opinionet e tyre, kanë kontribuar gjerësisht në përmirësimin e mëtejshëm të këtij projekti.

Është momenti për të kaluar në shqyrtimin projektligjit dhe ky është një moment shumë i rëndësishëm, që besoj se është edhe në vlerësimin e kolegëve për ta mbështetur. Besoj se jemi dakord në parim për të vazhduar me shqyrtimin e projektligjit nen për nen.

Ka ndonjë gjë tjetër para se të kalojmë në shqyrtimin nen për nen? Nuk ka.

Më falni, para se të vazhdojmë, zoti Smibert, zoti Hoxha dhe zoti Rakipi, nëse do të keni ndonjë gjë lidhur me diskutimin nen për nen, mund të ndërhyini.

Atëherë, vazhdojmë me nenin 1 “Objekti i ligjit.”

Fjalën e ka relatori.

Ulsi Manja - Neni 1 ka të bëjë me objektin e ligjit dhe ne propozojmë riformulimin e nenit, sepse janë shtuar edhe tri germa “ç”, “d” dhe “e”.

Së dyti, është shtuar në objektin e prokurorisë funksionimi i administratës së prokurorisë; statusi i nëpunësve civilë të prokurorisë dhe rregullimi i marrëdhënieve të prokurorisë mbi institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun. Pra, përveç atyre parashikimeve që ka neni 1, në objekt janë shtuar edhe 3 parashikime të tjera, për të cilat është rënë dakord paraprakisht me ekspertët.

Fatmir Xhafaj - Dakord?

Artan Hoxha - Jemi dakord, por dua të bëj një rregullim të vogël teknik, ku thuhet “prokuroritë e specializuara që ngrihen me ligj të posaçëm kur nuk parashikohet ndryshe prej tij”.

Fatmir Xhafaj - Keni të drejtë, sepse kemi një ligj të posaçëm për prokurorinë e Posaçme dhe atje ka rregullime. Nuk mund të ketë efekt ky për sa kohë është rregulluar atje.

Jemi dakord me sugjerimet e bëra nga relatori dhe nga zoti Hoxha.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 2 “Përkufizimet”.

Ulsi Manja - Neni 2, paragrafi i parë, germa “a” riformulohet si më poshtë: “Prokuroria e Posaçme është autoriteti përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit për veprat penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë”. Pra, është shtuar fjalia “përfaqësimi i akuzës në gjyq në emër të shtetit” ku është mbajtur në konsideratë versioni siç është te ligji i posaçëm.

Po ashtu, te neni 2, paragrafi i parë, germa “b” sugjerohet të hiqet fjala “përdoret” dhe të riformulohet si më poshtë: “Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar” është për t’iu referuar Prokurorisë së Posaçme dhe njësisë së pavarur hetimore, e cila do të quhet “Njësia e Posaçme e Hetimit”. Pra, hiqet fjala “përdoret” si çështje e teknikës legjislative.

Neni 2, paragrafi i parë, germa “ii” riformulohet: “Drejtuesi i prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për prokurorët që ushtrojnë detyrën ose funksionet pranë kësaj prokurorie”.

Fatmir Xhafaj - Por fjalët “detyra” dhe “funksionet” njëlloj janë!

Ulsi Manja - Pra, “ushtrojnë detyrën pranë kësaj prokurorie”. Këtu shtohet “pranë Gjykatës së Apelit” sepse prokuroria funksionon pranë gjykatës.

Fatmir Xhafaj - Zoti Hoxha, jeni dakord? Dakord.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Nëse i referohemi nenit 135 të projektit të ndryshimeve kushtetuese, ne kemi hequr dorë nga përdorimi i termit “funksionarë të lartë” dhe kemi vendosur t’i përcaktojmë qartë funksionarët. Njëkohësisht, kemi shtuar edhe ish-funksionarët në pozicionet që përmenden në nenin 35.

Fatmir Xhafaj - Nuk mund ta fusim këtu.

Vasilika Hysi - Në këtë kuadër, nëse të kujtohet *footnote*-i që shoqëronte nenin 135, te ndryshimet kushtetuese është vendosur të hiqet termi “funksionar i lartë”. Unë do të sugjeroja të thuhet këtu: “Akuza penale kundër funksionarëve të parashikuara në nenin 135, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.

Fatmir Xhafaj - E rregullon ligji i posaçëm atë gjë Vasilika.

Vasilika Hysi - Po nuk e kemi thënë pra.

Fatmir Xhafaj - Ky ligj thotë çfarë është prokuroria e Posaçme dhe nuk ka rëndësi se cilat janë kompetencat.

Vasilika Hysi - Jo, këtu funksionarët përcaktohen qartë.

Fatmir Xhafaj - Edhe një herë: ky është koncepti se çfarë është Prokuroria e Posaçme për efekt të këtij ligji, por objekti i punës dhe kompetencat e Prokurorisë së Posaçme janë në ligj dhe atje do ta shikojmë.

Vasilika Hysi - Unë po flas për grupin e personave që duhet t’i nënshtrohen.

Fatmir Xhafaj - Nuk merr zgjidhje në këtë ligj kjo gjë, por e merr te ligji i posaçëm.

Vasilika Hysi - Mund të lindë problemi se kush do të quhen “funksionarë të lartë” dhe këtë diskutim...

Fatmir Xhafaj - Se kush do të quhet funksionar i posaçëm është zgjidhur te ligji që e trajton atë.

Vasilika Hysi - Por ndërkohë ta ka përcaktuar Kushtetuta.

Fatmir Xhafaj - Normat kushtetuese trajtohen te ligji i posaçëm, ligji kuadër që rregullon fushën.

A ka gjë tjetër për nenin 2?

Ulsi Manja - Jo, nuk ka gjë.

Artan Hoxha - Nuk kemi gjë tjetër, thjesht mund të bëj një propozim. Meqenëse germa “b” “Struktura e posaçme kundër krimit të organizuar”, në fakt, nuk përmendet gjatë tekstit të ligjit, por përmendet vetëm prokurori i Posaçëm, ndoshta mund të mos jetë nevoja të qëndrojë, se nuk është në tekst

Fatmir Xhafaj - Dakord!

Artan Hoxha - Ajo është mirë për të bërë dallimin, por nuk përmendet. Kështu që vetëm dhënia e shpjegimit se çfarë është Prokuroria e Posaçme është e mjaftueshme, kurse vetë struktura nuk përmendet në tekst.

Fatmir Xhafaj - Gjithsesi ka edhe një gjë. Në momentin që do ta zbardhim tekstin do të shikojmë edhe një herë para votimit.

Dakord me ndryshimet e nenit 2.

Vazhdojmë me nenin 3 “Objekti i veprimtarisë së prokurorisë”.

Ulsi Manja - Në lidhje me nenin 3 dua të bëj një pyetje për ekspertët. Në nenin 3 thuhet: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj”. Këtu të krijohet ideja se prokuroria nuk kryen hetime me këtë parashikim. Pra, thjesht drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore. A mos do të ishte nevoja të shprehem: “Merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin me vendimeve penale, bën hetime, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore”, sepse prokurorit edhe sot nuk ia mohon ligji të drejtën të kryejë veprime hetimore.

Pra, në nenin 3 të krijohet ideja se prokurori tashmë do të ushtrojë ndjekjen penale, do të bëjë përfaqësimin e akuzës, do ta drejtojë dhe do të kontrollojë veprimtarinë e Policisë Gjyqësore. A mos ndoshta është e nevojshme të shtojmë fjalën “bën hetime”? Si mendoni?

Artan Hoxha - E thënë kështu siç është nuk e përjashton bërjen e hetimeve, kurse e thënë në mënyrë të shprehur mendoj se nuk do të theksonte, si të thuash, atë që në mendojmë se duhet të ndryshojë disi në veprimtarinë e prokurorisë, që prokuroria kryesisht i drejton dhe ushtron ndjekjen penale dhe autoriteti që zhvillon hetimet, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, është Policia Gjyqësore.

Fatmir Xhafaj - A e përfshin ushtrimin e ndjekjes penale?

Artan Hoxha - E përfshin, sepse edhe ku thuhet “kryen detyra të tjera të parashikuara në ligj” është Kodi i Procedurës Penale që ia përcakton prokurorit funksionet. Nuk kemi dashur ta theksojmë në mënyrë të posaçme, sepse zhvillimi mund të bëjë më vonë

që këto funksione duhet të jenë më të ndara me kalimin e kohës. Kështu siç është nuk e ndalon prokurorin që të zhvillojë hetime, por nuk kemi dashur që ta theksojmë.

Fatmir Xhafaj - Çfarë problemi do të kishte nëse do të thoshim: “Prokuroria kryen hetime, ushtron ndjekje penale dhe përfaqëson akuzën”, sepse ne gjatë gjithë kohës themi që prokurori të kryejë hetime në mënyrë proaktive?

Artan Hoxha - Nëse duam ta themi këtë, unë jam dakord me propozimin. Ndjekja penale, në fakt, nuk është kryerja e hetimeve, por është ushtrimi tipik i funksioneve të prokurorit.

Fatmir Xhafaj - Atëherë, ta përfshijmë që të jemi më të qartë edhe për funksionin e prokurorisë. Pra, kryen hetime...

Artan Hoxha - Mund të thuhet: “Heton, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore”

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Rakipi.

Arben Rakipi - Çështja në qoftë se prokurori bën ose jo hetime është e qartë dhe është e rregulluar në procedurën penale, kështu që përfshihet në termin “edhe detyra të tjera të parashikuara me ligj”.

Unë jam kundër vendosjes së termit “zhvillon hetime”, sepse nëse ne do të vendosnim këtë term, do të krijojmë keqkuptimin që hetimet i bën prokurori dhe nuk i bën policia. Kështu që për të evituar këtë keqkuptim ose atë që mund të na ndodhë nesër në praktikë, një përplasje e madhe për faktin se kush do t’i zhvillojë hetimet, sipas meje është gabim të përshkruhet kështu.

Prokurori në fazën e hetimeve dihet se çfarë kompetencash ka. Kontaktin me Policinë Gjyqësore e vë vetëm në pozicionin e kontrollit të drejtimit të Policisë Gjyqësore dhe në njëfarë kuptimi ky është një zhvillim hetimi.

Fatmir Xhafaj - Nëse i shkojmë kësaj logjike, mund ta bëjmë “drejton dhe kontrollon veprimtarinë hetimore të Policisë Gjyqësore”.

Arben Rakipi - Veprimtaria e Policisë Gjyqësore është hetimore.

Fatmir Xhafaj - Atëherë, dakord.

Faleminderit!

Neni 4 “Ligjshmëria e veprimtarisë”.

Ulsi Manja - Neni 4, paragrafi i parë propozohet të riformulohet: “Prokurorët në ushtrimin e detyrës i nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve”. Këtu sugjerohet të shtohet “akteve nënligjore, aktet e prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorit më të lartë”.

Nuk e di si do ta gjykonin ekspertë këtë riformulim? A është e nevojshme ta shtojmë në ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë?

Artan Hoxha - Kështu siç është shkruar unë mendoj se e plotëson edhe atë nevojën që ju doni të theksoni me akte nënligjore e me radhë. Po the “legjislacionit në fuqi” e ke të përfshirë, sepse legjislacioni në fuqi është çdo gjë që ligji e lejon që të rregullohet edhe me akte të tjera. Kështu që personalisht do të thosha se formulimi, ashtu siç është, është më konciz dhe e nënkupton se çfarë bëhet fjalë. Nëse do të thoshim (se ka dispozita parimore) “aktet e prokurorit të Përgjithshëm dhe të prokurori më të lartë” do të dukej sikur do ta decentralizonim prokurorinë. Pra, është risku që në një normë parimore të krijojmë një strukturë të centralizuar.

Në dispozitat e posaçme ne kemi rregullime se si zbatohen udhëzimet e karakterit të përgjithshëm dhe udhëzimet e karakterit për çështje jodetyruese për çështje të veçanta. Unë personalisht do të preferoja të mbetej kështu siç është.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Zonja Hysi, kishit diçka?

Vasilika Hysi - Ndjesë që kthehem mbrapa, por në nenin 2 duhet bërë edhe renditja sipas rendit alfabetik.

Fatmir Xhafaj - Dakord me vërejtjen tuaj, do të merret në konsideratë nga sekretaria teknike në zbardhje.

Neni 4? Dakord.

Neni 5? Dakord.

Neni 6 “Pavarësia e prokurorëve”?

Ulsi Manja – Në paragrafin e parë të nenit 6 është përmendur parimi i paanshmërisë, por në vijim të projektligjit, ai nuk është parashikuar si parimet e tjera, pra thuhet: “...bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë”. Kur flitet te parimet pastaj, parimi i paanshmërisë nuk është trajtuar në projektligj. A është nevoja të trajtohet në projektligj edhe parimi i paanshmërisë, si parim i rëndësishëm?

Artan Hoxha – Paanshmëria në vetvete është pjesë e pavarësisë, domethënë është segment. Kur flasim për pavarësinë, pjesë e pavarësisë është edhe paanshmëria, e cila ka të bëjë me raportin e prokurorit në lidhje me çështjen, kurse pavarësia ka të bëjë me raportin që ka prokurori, në tërësinë e vet, me institucionet dhe me subjektet e tjera të procesit penal.

Paanshmëria është element i pavarësisë dhe janë nenet 15, 16, 17 të Kodit të Procedurës Penale. Përmendja “në pavarësi”, mendoj se e plotëson edhe elementin e paanshmërisë.

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Për të qenë koherente, duhet që pas “orientimit seksual” të shtohet identiteti gjinor. Është protokollu 12 i konventës.

Fatmir Xhafaj – Pra, dakord me nenet 6 dhe 7.

Neni 8.

Artan Hoxha – Te neni 8 është gjinia?

Vasilika Hysi – Jo, te neni 7.

Artan Hoxha – Jo, gjinia është te neni 8.

Fatmir Xhafaj – “Objektiviteti dhe barazia”.

Vasilika Hysi – Jo, ishte te “Objektiviteti dhe barazia”...

Fatmir Xhafaj – Po, është neni 8.

Vasilika Hysi – Te baza mbi të cilën ndalohet diskriminimi. Është neni 7. Ndërkohë, ju e keni rimarrë te neni 8, por unë e plotësova te neni 7.

Fatmir Xhafaj – Më fal, zonja Hysi, neni 7 është “Mbrojtja e statusit të prokurorit”. Gjinia është te neni 8.

Vasilika Hysi – Më fal, te neni 8, po!

Ulsi Manja – Te neni 8 sugjerohet të shtohet një pikë 8/a lidhur me paanësinë dhe është rënë dakord të shtohet 8/a lidhur me paanësinë, pra të thuhet: “Prokurorët në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo të detyrave të tyre duhet të ...” dhe përmenden gerrat.

Artan Hoxha – Nuk shoh ndonjë diferencë. E kam hapur nenin 8 këtu përpara.

Ulsi Manja – Jo, është neni 8/a.

Artan Hoxha – Më fal! Bëhet fjalë për nenin 8/a.

Fatmir Xhafaj – Ka nevoja të rishikohet nëse bini dakord apo jo për shkak, sepse është ...

Ulsi Manja – Në qoftë se do të biem dakord të japim përkufizimin e paanshmërisë, ne propozojmë të shtohet një nen 8/a.

Artan Hoxha – Paanshmëria ka të bëjë me pozitën e prokurorit në raport me çështjen konkrete, që, siç thashë, është pjesë e pavarësisë, por ka të bëjë me çështjen konkrete. Pra, elementin e paanshmërisë së prokurorit, ne e gjejmë si element procedural, që do të thotë se në të gjitha rastet, kur përcaktohet pajtueshmëria apo papajtueshmëria e prokurorit me çështjen konkrete, është rregullim i procedurës penale. Marrja përsipër e të thënit të gjërave të pakoordinuara me procedurën penale mund të rrezikojë që kjo dispozitë, në dukje parimore, të na krijojë probleme me vetë normën procedurale. Kështu që duke thënë se paanësia e prokurorit është element i pavarësisë së tij dhe që këtë element e zgjidh procesi

penal në veçanti, unë do të mendojem, megjithëse si formulim është një tentativë e mirë, por mund të na krijojë një përplasje me dispozitën procedurale.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë jam dakord me zotin Hoxha, veçse parimet që janë përcaktuar në nenin 8/a janë të domosdoshme të jenë në ligj, pasi flitet për ndalimin e torturës dhe të trajtimeve degraduese poshtëruese.

E dyta, është e domosdoshme të përcaktohet prezumimi i pafajësisë dhe, njëkohësisht, është shumë interesant parashikimi i bërë në germën “dh”, ku thuhet: “Prokurorët duhet të jenë të gatshëm, jotolerant dhe të hapur për të ofruar diskutime dhe zgjidhje të ofruara në mënyrë të ligjshme”, pra sipas mendimit tim të gjitha parashikimet që bëhen në nenin 8/a nuk lidhen me paanësinë se sa lidhen me respektimin e të drejtave dhe parimeve të rëndësishme në proces, që duhet të jenë në këtë ligj, por kurrsesi nën termin paanësi. Me këtë unë jam dakord me ju.

Fatmir Xhafaj – T’i lëmë kohë zotit Hoxha t’i shohë. Nëse këto çmohen dhe janë të nevojshme, ne mund t’i përfshijmë. Nëse debati do ta sjellë që të jenë në nivelin e Kodit Etik, le të jenë në Kodin Etik.

Dakord, ngelet një çështje për t’u parë.

Vazhdojmë me nenin 9: “Konfidencialiteti i të dhënave”

Ulsi Manja – Dakord me nenin 9, por në paragrafin e dytë të hiqen fjalët “ që mund” dhe “ato që”, sepse janë çështje të teknikës legjislative.

Vasilika Hysi – Unë kam dy pyetje, zoti Hoxha.

Pyetja e parë lidhet me paragrafin e dytë. Kur thoni: “prokurorisë nuk i lejohet”, e keni fjalën për prokurorinë si institucion apo prokurorëve, sepse në mendimin tim, prokuroria mund të ketë një zëdhënës, i cili mund të japë të dhëna, pa dyshim, pa dëmtuar.

E dyta, nuk shoh në ligj, as në këtë nen, por as në vijimësi mbrojtjen e të drejtave të viktimave ose personave të dëmtuar. Flitet për mbrojtjen e të drejtave të të miturve, por nuk flitet për pjesën e të drejtave të personave të dëmtuar, apo, siç do të jepni përkufizimet, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të viktimës. A nuk do të ishte me vend që të fusim për herë të parë elemente, të cilët tashmë ...

Fatmir Xhafaj – Dakord, por të mos e marrim Kodin e Procedurës Penale e ta sjellim në ligjin e prokurorisë.

Vasilika Hysi – Jo, kjo flet për konfidencialitetin e të dhënave. Nëse flasim për jetën private, në përgjithësi...

Fatmir Xhafaj – Doni ta përfshini edhe atë?

Vasilika Hysi – Term është. Ne flasim për mbrojtjen e të drejtave të të miturve dhe shumë mirë, sepse do të kemi një kod të veçantë për të miturit, por, nga ana tjetër, në dijeninë time, në Kodin e Procedurës Penale parashikohet një kapitull i tërë për mbrojtjen e të drejtave të personit të dëmtuar, që në praktikën e sotme është injoruar.

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha – E para, mendoj se dispozita i përfshin të dëmtuarit. Është më e gjerë sesa vetëm për të dëmtuarin dhe është dispozitë parimore.

E dyta, ne kemi rregullim të posaçëm më tutje, kur flasim për mënyrën se si prokuroria bën publike çështje që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së prokurorisë në tërësinë e vet, por edhe për çështje të veçanta, duke ruajtur konfidencialitetin dhe sekretin, por është një dispozitë e posaçme.

Fatmir Xhafaj – Mund të thuhet edhe “prokurorëve”, sepse prokurorët i kanë..

Artan Hoxha – Kur themi “prokurorisë”, nuk është thënë pa qëllim, që prokuroria si institucion nëpërmjet prokurorëve të veçantë apo titullarit është e ndaluar të japë të dhëna, të cilat janë konfidenciale, janë sekrete, janë të tilla...

Fatmir Xhafaj – Te pika 1, ju përdorni termin “prokuror”, te pika 2 “prokuroria”. Përdorni në të dyja të njëjtin term, mos përdorni dy. Unifikojeni!

Artan Hoxha – Mund të thuhet “prokurorët”, por kjo dispozita e dytë është si më gjenerike dhe është e gjithë struktura.

Fatmir Xhafaj – Sepse edhe te e para, brenda një neni keni dy subjekte.

Artan Hoxha – Po të shikojmë në dispozitat e posaçme, zoti kryetar, aty ne nuk kemi vetëm prokurorin që komunikon me publikun, por kemi edhe zëdhënësin, apo atë që është ngarkuar nga prokurori për të ...

Fatmir Xhafaj – Ju keni thënë: “...prokurorët dhe i gjithë personeli i prokurorisë”, pra edhe këtu mund të thoni “...prokurorët dhe gjithë personeli” ose mund të thoni për të dyja “prokurorisë nuk i lejohet...”

Artan Hoxha – Kur kemi thënë “prokurorisë”, e kemi futur të gjithë...

Fatmir Xhafaj – Mirë, po në pikën 1 keni një temë tjetër, në pikën 2 keni...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Rakipi – Kam diçka teknike te paragrafi i parë. Tani po e shoh dhe më duket sikur mund të sjellë keqkuptim.

Paragrafi i parë detyron prokurorët që gjatë ushtrimit të detyrës, edhe kur e lënë detyrën, të mos bëjnë publike gjëra konfidenciale. Kështu që kam përshtypjen se fjalët “si dhe pas përfundimit të saj” duhet të dalin menjëherë pas “prokurorët dhe i gjithë personeli i prokurorisë, edhe pas përfundimit të detyrës, janë të ndaluar, janë të detyruar e të tjera”, sepse këtu ku është vendosur, më duket sikur krijon një keqkuptim me marrjen në dijeni, kur ata kanë marrë dijeni gjatë detyrës apo pas ushtrimit të detyrës.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 9, me ndryshimet.

Neni 10 “Respektimi i rregullave të etikës dhe sjellja profesionale.

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi - Kam diçka. Këtu përdoren fjalët “prokurorët duhet të ruajnë nderin e profesionit dhe dinjitetin e profesionit”. A mund të ketë një terminologji tjetër, sepse ne themi “nderi dhe dinjiteti i njeriut”, por të themi “nderi dhe dinjiteti i profesionit”, më duket sikur në shqip nuk funksionon.

Fatmir Xhafaj – Po kur themi “profesion i nderuar”, është shqip? Pra, ne themi “ai është profesion dinjitoz”, por themi edhe “profesion i nderuar”.

Artan Hoxha – Kjo nuk është merita ime, por është thënë bukur, sepse aty ai nuk është si individ; ky individ është prokurori. Kur ruan dinjitetin e funksionit, ai ka ruajtur edhe dinjitetin e njeriut, pra e ka brenda, e ka të detyrueshme.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 11: “Ushtrimi i funksioneve të prokurorisë vetëm nga prokurorët”.

Ulsi Manja – Te 11, në variantin që propozohet, thuhet: “Delegimi i funksionit të prokurorisë apo marrja përsipër e këtyre funksioneve nga autoritetet e tjera është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe”.

Ne propozojmë të thuhet: “...me përjashtim të rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale”.

Fatmir Xhafaj – “Kur me ligj është parashikuar ndryshe dhe...”

Artan Hoxha – Këtu kemi diskutim.

Ulsi Manja – Bëhet fjalë për delegimin e posaçëm, sepse sot Kodi i Procedurës penale ka delegim të përgjithshëm të kompetencave, por ka edhe delegim të posaçëm.

Paragrafi i dytë i referohet, me sa kuptoj, delegimit të posaçëm. Çfarë është delegimi i posaçëm? Janë veprime hetimore që lidhen ngushtësisht me funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale, që, konkretisht ka të bëjë me njoftimin e akuzës, me marrjen në pyetje të të pandehurit dhe me dërgimin e çështjes në gjyq. Këto janë funksione të lidhura

tërësisht me atributet e të qenit prokuror. Në rastet përjashtimore, këto mund t'i delegohen oficerit të Policisë Gjyqësore.

Në nenin 11 thuhet “..me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe”. Diskutimi është: do ta lejojmë këtë formë të delegimit të posaçëm në ushtrimin e ndjekjes penale, apo jo? Ne themi: “...referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale”, por kur thuhet: “me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe”, këtë le të na shpjegojnë ekspertët më qartë.

Artan Hoxha – Kjo nuk lidhet vetëm me Kodin e Procedurës, por është një gjë, që do ta pranoni apo jo ju, vjen në nenin 71, por që vjen si modeli i ligjit “Për organizimin gjyqësor”, që për mua nuk duhet, por ne e kemi lënë për ta diskutuar, neni 71 flet për prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe një nga funksionet që u lihet prokurorëve të komanduar nëpërmjet paragrafit të dytë, është që të përfaqësojnë Prokurorinë e Përgjithshme në çështjet gjyqësore me karakter civil dhe administrativ. Ky është neni 71 i këtij projekti.

Fatmir Xhafaj – Po, po: “Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë”.

Artan Hoxha – Jo, unë e kam të integruar. Më duket se është neni 64; ta shikoj pak. Po, është neni 64: “Prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme”, të cilët janë ata që ju thatë me të drejtë, zoti deputet, zëvendësojnë ndihmësit ligjorë dhe një funksion që i është dhënë ndihmësit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme është të përfaqësojë Prokurorinë e Përgjithshme në çështje gjyqësore të karakterit civil dhe administrativ në Gjykatën e Lartë. Kjo është parashikuar, duke pasur parasysh ndihmësit në tërësinë e tyre, ose jo ndihmësit, por ata që quhen “gjyqtarët e komanduar” në ligjin “Për organizimin gjyqësor”.

Tani, kjo është një çështje e harmonizimit të legjislacionit, por nëse kërkohet mendimi im, unë them që kjo nuk duhet të jetë në ligjin “Për prokurorinë”. Nuk e di se si është në ligjin “Për organizimin gjyqësor”, por unë nuk jam që në çështjet administrative dhe civile, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme të përfaqësojnë prokurorinë, kur ligji e parashikon Prokurorinë e Përgjithshme në Gjykatën e Lartë apo në atë Kushtetuese. Kështu që po u la kështu, atëherë kur te referenca thuhet: “sipas rregullimeve në ligj”, nuk është vetëm Kodi i Procedurës Penale, prandaj është pak më e gjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfaqësues është ai, është delegim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të vijmë te neni 71.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk është ndonjë gjë e madhe. Po u tha: “...me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe...”

Artan Hoxha – Nëse thuhet: “...të parashikuar me ligj”, unë them më mirë të lihet e hapur për rregullime.

Ulsi Manja - Dakord me shpjegimet në lidhje me nenin 64, pra është më i përshtatshëm përdorimi siç është aktualisht, por unë kam një shqetësim tjetër lidhur me këtë pikë. Ndoshta diskutimi është parimor.

Artan Hoxha – Te Kodi i Procedurës Penale, pastaj.

Ulsi Manja – A duhet të parashikohet kjo formë e delegimit të posaçëm apo jo, sepse me eksperiencën e deritanishme, prokurorët në Shqipëri nuk kanë asnjë pikë kontakti me të pandehurin ose me personin nën hetim, me përjashtim të përcaktimit të masës së sigurimit dhe të gjykimit. Në rutinën e punës, këto veprime procedurale, në masën 90 e ca % të rasteve, u delegohen oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Fatmir Xhafaj – Po, por këtë do ta shohim te Kodi i Procedurës Penale, kur të vijë Kodi i Procedurës Penale.

Ulsi Manja – Kur të vijmë te Kodi i Procedurës Penale, kjo pjesë duhet parë, gjithsesi unë jam i hapur për këtë pikë.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Rakipi.

Arben Rakipi - Nuk ka qenë ky qëllimi i nenit 11.

Lidhur me të metën që konstaton deputeti Manja, edhe ne e kemi konstatuar dhe kemi qenë të gjithë dakord që prokurori në këto pika, që përmendi zoti Manja, duhet të jetë prezent, sepse përndryshe e humb kontaktin me procesin penal dhe pastaj del si artificial në të. Qëllimi i pikës dy është tjetër gjë dhe bëhet fjalë për rastet kur prokurori në çështje shumë të thjeshta, të cilat janë hetuar nga organizma administrative përkatëse, mendon të zbusë ngarkesën e tij dhe autorizon një zyrtar të asaj administrate e i thotë: “Shko përfaqësoje ti çështjen në gjyq në emrin tim”. Bëhet fjalë për gjëra si: pushtim toke etj. Pra, janë këto gjërat e thjeshta që ndodhin çdo ditë. Është një rutinë aq e madhe saqë për të evituar ngarkesën, përdor një mekanizëm dhe e fton ose çon autoritetin administrativ në gjyq në emër të prokurorisë.

Fatmir Xhafaj – Të mbetet siç është, thoni ju.

Arben Rakipi – Unë e kam thënë dhe shkruar këtë. Kështu si po e diskutoj sot, është diskutuar edhe te ne dhe nuk kemi rënë dakord në këtë pikë. Kjo ka mbetur, sepse përfshin atë që thotë edhe zoti Manja. Duke përfshirë edhe atë ka mbetur, por qëllimi i parë që është shkruar ka qenë ky që thashë.

Artan Hoxha – Ne i kemi bërë një *footnote* kësaj dhe *footnote* i kësaj ka qenë nëse do të vazhdojë të lejohet delegimi nga prokurori i funksionit të ushtrimit të ndjekjes penale të oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Atë që thotë zoti Rakipi dhe CEPEJ i ka bërë një sugjerim Shqipërisë, lidhur me funksionet e prokurorit, i cili mund të ketë edhe disa funksione të tjera. Ne nuk e shikojmë në rregullimet procedurale të ofruara deri tani nga Ministria e Drejtësisë. Diskutimi nëse prokurori mund të delegojë funksione të tij, strukturave të tjera, qoftë edhe oficerit të Policisë Gjyqësore, nuk e kemi në ndonjë rregullim, sot që flasim, por e kemi thjesht si mund të ndodhë, por nuk ka ndodhur në asnjë projekt të reformës që ju keni sot përpara, nuk ka ndonjë rregullim të kësaj natyre.

Po të shkojmë strikt te funksionet e prokurorit në procesin penal, unë jam absolutisht kundër asaj që ndodh sot, që prokurori funksionet e ndjekjes penale, që janë tre, siç tha edhe deputeti i nderuar: njoftimi i akuzës, marrjes së të pandehur dhe pyetja e të pandehurit, këto nuk duhet t'ia delegojë Policisë Gjyqësore, sepse ndërkohë që deputeti ka shqetësimin që ta fusim edhe atë që bën hetim, prokurori jo vetëm që nuk bën hetim, jo vetëm që nuk realizon drejtimin e hetimeve, por edhe atë që është funksion, që e ndan funksionin e prokurorit, nga funksioni i hetimit, që është ndjekja penale, edhe atë ia delegon Policisë Gjyqësore.

Kështu që në këtë pikëpamje ky ishte diskutimi që ne kemi lënë të hapur, duke qenë strikt tashmë pas bisedimeve që kemi bërë në komision.

Ne mund ta ndalojmë në Kodin e Procedurës Penale dhe ta lëmë të hapur këtë. Këtu po u hoq fare me përjashtim të rasteve, domethënë ai nuk ka të drejtë të delegojë.

(I drejtohet kryetarit të komisionit) Nuk i kemi rastet e tjera. Rastet e tjera do të ishin nëse ne do të prananim në rregullimet tona ligjore...

Hetimi paraprak ka dy funksione: ka funksionin e hetimit dhe funksionin e ndjekjes penale. Funksionin e hetimit e kryen Policia Gjyqësore, e kryen edhe prokurori. Nuk ndalohen. Kurse funksionet e ndjekjes penale janë tipike të prokurorit. Këto funksione të ndjekjes penale prokurori shpesh i delegon te Policia Gjyqësore. Kur flasim për funksionet e prokurorit, këto janë funksionet e prokurorit, në fakt. Funksionet përveç proceduralisht ia kemi thënë prokurorit edhe në atë dispozitën që thotë se çfarë kryen prokurori.

Fatmir Xhafaj – Zoti Rakipi, urdhëroni!

Arben Rakipi – Pika 2 ka kuptim vetëm në rastin eventual të asaj zgjidhjeje që unë thashë. Nëse ajo zgjidhje bie, sepse quhet joefektive, pika e dytë duhet të bjerë, sepse ne të gjithë jemi dakord që prokurori atributet e tij gjatë ndjekjes penale duhet t'i ushtrojë vet dhe jo t'i delegojë.

Për rrjedhojë, pika 2 bie tërësisht dhe ne duhet të bëjmë kujdes në procedurën penale, që edhe ato keqkuptime që na lindin nga praktika t'i modifikojmë atje duke mos lënë prokurorin të autorizojë oficerët për të bërë punën e prokurorit.

Pra, këtu jemi. Nëse do të mbetet alternativa që thashë, mbetet pika 2. Nëse alternativa bie, bie e gjithë pika 2.

Vasilika Hysi – Zoti Rakipi, kam një pyetje. Kur ju keni parashikuar shprehjen “me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe”, fjalën e keni për këtë ligj apo i lini hapësirë edhe mundësisë në ligje të tjera? Sepse po të jetë për Kodin e Procedurës Penale, çështja ndryshon, por po thatë “me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe”, del që përveç Kodit të Procedurës Penale është edhe ky ligj. Po të jetë se është edhe ky ligj është më mirë të thuhet “me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj dhe në Kodin e Procedurës Penale.”

Arben Rakipi – Pika 2 duhet diskutuar në këndvështrimin që ju ofrova unë. Nëse alternativa që kam ofruar bie, atëherë bie edhe pika 2, sepse ne të gjithë jemi dakord që të metat e shfaqura gjatë procesit penal deri më sot janë të atilla që e lejojnë prokurorin të mos ushtrojë detyrën e tij, por ta bëjë atë nëpërmjet oficerit të policisë.

Fatmir Xhafaj – Mund të ketë dy-tre elemente, që janë detyruese, siç e thatë edhe ju, pra, disa veprime që janë të nevojshme, që ai mund t'i delegojë. Duke hequr fare këtë ne e kufizojmë këtë mundësi, ose e përjashtojmë këtë mundësi. Ka të tilla?

Arben Rakipi – Ne konstatojmë si të metë thelbësore, e përmendi zoti Hoxha, faktin që prokurori autorizon oficerët e policisë për ato punë që duhet t'i bëjë prokurori.

Fatmir Xhafaj – Atëherë i bie që ta heqim fare pikën 2 në qoftë se...

Arben Rakipi – Nëse bie alternativa që unë thashë, që në gjyq në emër të prokurorit të shkojë dikush tjetër, pika 2 bie.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Artan Hoxha - Për ta lënë të hapur legjislacionin për rregullime të mëtejshme, plus që kemi edhe për t'iu përgjigjur pyetjes së zonjës deputete, nuk është fjala për këtë ligj. Fjala “kur ligji parashikon ndryshe” është fjala në përgjithësi dhe legjislacioni që lidhet me fushën e drejtësisë penale janë edhe përgjimet, ligjet antimafia, Kodi i Procedurës Penale, ky ligj i posaçëm, ligji i Prokurorisë së Posaçme antikorruption. Kjo është një dispozitë e karakterit të përgjithshëm.

Ligji këtu është gjenerik në rregullimin e tij dhe rregulli është që nuk i delegon kompetencat e tij, por mund të jenë disa gjëra që ne nuk mund t'i parashikojmë dot sot, sepse diskutimet janë moderne.

CEPEJ të thotë që prokurori mund të delegojë ose mund të zgjidhë vetë. Për shembull, CEPEJ ka dhënë propozimin që prokurori mund të zgjidhë çështjet e vogla. Ne kemi parashikuar në Kodin e Procedurës Penale zgjidhjet me dekret të çështjeve, por që në fund të ditës kërkojnë ratifikimin e gjykatës, që do të thotë përsëri nuk është autoriteti i plotë i prokurorit. Nesër mund të ketë edhe rregullime të tjera dhe unë them që nuk kemi pse e ndalojmë këtë rregullim të mëtejshëm, por duhet të themi, sipas vlerësimit tim, duhet të vazhdojë fjalia “presje, me përjashtim të rasteve të funksioneve, me përjashtim të funksioneve të ndjekjes penale”. Kur themi “ me përjashtim të funksioneve të ndjekjes penale”, këto nuk mund t’i delegojë.

Pra, shqetësimi që kemi është se po të lexohet: “delegimi i funksioneve të prokurorisë apo të marrjes përsipër të këtyre funksioneve nga autoritete të tjera është e ndaluar me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe,” pra dalin dy përjashtime, por duhet theksuar diku që...

Fatmir Xhafaj – Atëherë ta lëmë të hapur që të bëjmë një diskutim për ta riformuluar? Neni 11 mbetet i hapur.

Neni 12. Struktura e prokurorisë.

Ulsi Manja - Në lidhje me nenin 12 ne propozojmë të ndahet në dy paragrafë. Në paragrafin e parë është me të njëjtën përmbajtje, por në dy paragrafë, ku të qartësohet me paragraf më vete që prokuroria e posaçme organizohet dhe funksionon sipas rregullave të parashikuara me ligj të posaçëm. Thjesht për të bërë dallimin me prokurorinë dhe prokurorinë e posaçme. Gjithsesi, përmbajtja nuk ndryshon aspak.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këtë ndryshim? Për mua është e shkruar më mirë kështu siç është.

Artan Hoxha – Kështu siç është, tërheq vëmendje, sepse kur të shkojmë te SPACU, ai nuk është i organizuar sipas sistemit gjyqësor. SPACU është i organizuar si strukturë më vete dhe e përfaqëson në të gjithë sistemin gjyqësor, e thënë kështu në një fjali “që prokuroria funksionon pranë sistemit gjyqësor me përjashtim të prokurorisë që rregullohet me ligj të posaçëm që nuk funksionon sipas organizmit...”

Fatmir Xhafaj - Dakord. Është më e saktë.

Neni 13. Degët e prokurorive.

Ulsi Manja – Për degët e prokurorive kemi problem brenda vetes.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Edhe unë kam disa shqetësime lidhur me degët e prokurorive.

Ju keni marrë modelin e degëve të gjykatave dhe në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” flitet për mundësinë që gjykatat të kenë degë.

Ndërkohë, në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” janë përcaktuar kritere dhe standarde sesi krijohen degët, por, njëkohësisht, si mund të përcaktohen ose të caktohen gjyqtarë në këto degë, qoftë të përhershme apo të përkohshme.

Në paragrafin e dytë të këtij neni ju ia keni lënë Këshillit të Lartë të Prokurorisë t’i caktojë çdo dy vjet prokurorët, duke hedhur short. Në fakt, deri më sot ne flasim në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë penale, për nevojën e specializimit të profilizimit të kualifikimit të prokurorëve.

Ne flasim për të shkuar drejt prokurorëve, të cilët janë të specializuar në një fushë të posaçme dhe këtu kam parasysh një lëvizje disi kontradiktore me gjetjet e raportit të analizës analitike që i keni bërë gjendjes së sistemit gjyqësor dhe drejtësisë penale dhe nismës që është marrë për të krijuar, për të pasur një legjislacion të veçantë për një kod të fëmijëve .

Mua më shqetëson ky fakt, sepse nuk e gjej në këtë ligj aspak idenë që për të miturit duhet të ketë prokuror dhe gjyqtarë të specializuar dhe që ai dëm që është bërë sot në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, që i jep të drejtë kryetarit të gjykatës apo prokurorisë t’i lëvizë çdo dy vjet...

Ideja ime, zoti kryetar, është që pika 2 duhet të përcaktojë qartë disa kritere dhe procedura siç i ka ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Fatmir Xhafaj – Nuk po flasim për seksionet brenda prokurorive. Po flasim për degët e prokurorive, që janë jashtë prokurorisë së rrethit gjyqësor.

Vasilika Hysi – Këtu flitet për caktim prokurorësh. Nuk mund të caktohen prokurorë...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zonja Hysi, shikojeni me vëmendje!

Vasilika Hysi – Bie ndesh me standardet edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Është me konventën që kemi ratifikuar për të drejtat e fëmijëve. Kjo bie ndesh me të gjitha rekomandimet CEPEJ apo me institucionet e tjera europiane për drejtësinë penale të të miturve dhe me nismën që ne kemi marrë për sipër për të pasur një drejtësi të profilizuar dhe prokurorë dhe gjyqtarë të specializuar.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, askush nuk i vë në diskutim parimet dhe vlerat që mbrojnë ju, por nuk e kanë vendin këtu.

Edhe një herë, zonja Hysi, nuk e kanë vendin këtu. T’jua sqaroj më thjeshtë.

Nëse sot është prokuroria e Pogradecit dhe e Korçës, nesër mund të jetë vetëm prokuroria e rrethit gjyqësor Korçë, pra, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, nuk do të ketë

Gjykatë të Shkallës së Parë për një moment në Pogradec, por do të lindë nevoja që gjykata të caktojë degë në Pogradec. Edhe këta do të caktojnë degë, por degë jo seksione të specializuara. Pra, këtu po flasim për degë nga pikëpamja institucionale dhe kur të flasim për seksione do të flasim për idenë tuaj.

Pika 2 bën fjalë për të caktuar se cili do të shkojë te këto degë. Cilët do të punojnë te këto degë? Si do të caktohet ai që do të shkojë të punojë në Pogradec? Si do të caktohet ai që do të shkojë të punojë te dega e prokurorisë së rrethit gjyqësor? Janë dy gjëra të ndryshme. Mos insistoni, ju lutem!

Edhe një herë, po flasim për degët si... Për t'i caktuar te dega, jo te seksioni, edhe një herë. Të mos bëjmë një debat kur është e zeza mbi të bardhë, e kuptojnë të gjithë. Ti do të realizosh atë qëllim, që është shumë i drejtë, por kur t'i vijë radha.

Po, pra 22 janë seksionet. Është një nen më vete. Kur të shkojmë te 22 insisto...

Ulsi Manja - Zoti kryetar, lidhur me degët e prokurorive ne duhet të ndjekim të njëjtin riformulim që është bërë edhe te ligji. Pra, prokuroritë ndjekin rregullin që funksionojnë pranë gjykatës. Sigurisht edhe pranë degës. Kështu që nga pikëpamja e formulimit të kësaj dispozite duhet të kemi të njëjtin formulim me dispozitën e ligjit që kaluam.

Ndërsa, lidhur me shqetësimin që ka kolegia Hysi, absolutisht unë ndaj mendim të njëjtë me kryetarin që bëhet fjala jo për seksion, por për degë prokurorie.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord që ta përshtatim 13-ën me ligjin “Për organizimin...

Neni 14. Organizmi i prokurorisë dhe përfaqësimi i saj.

Neni 14, pika 1, germa “b” hiqet fjala “të veçantë” dhe zëvendësohet me fjalën “ të posaçëm”.

Ka probleme? Dakord.

Artan Hoxha – Neni 14 mund t'i bëjmë një ndryshim titulli?

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Artan Hoxha – Titulli thotë “Organizimi i prokurorisë dhe përfaqësimi i saj”. Mund të thuhet ndryshe “Organizmi dhe drejtimi i prokurorisë”.

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Në paragrafin 2 mendoj se është parazit shprehja “ sipas këtij organizimi”. Mund të thuhet “organizmi dhe drejtimi i prokurorisë bëhet respektivisht nga...” .

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 15. Prokuroria e Përgjithshme.

Kemi ndonjë gjë? Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Kam një sugjerim për riformulimin e pikës 1, ku thuhet “Prokuroria e Përgjithshme ka reduksion mbi gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka selinë në Tiranë.”

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ju lutem urdhëroni!

Arben Rakipi – Neni 15, pika 3. Kam përshtypjen që neni 15, pika 3 duhet të koordinohet me nenin 2, ku bëhet fjalë për prokurorin më të lartë, sepse këtu thuhet: “Funksionet e Prokurorisë së Përgjithshme ushtrohen nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme”.

Kuptimi im është që një prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme do të bëjë funksionet e prokurorit të Përgjithshëm, pak a shumë. Kështu thuhet në pikën 3. Ndërsa si prokuror më të lartë, njihet vetëm prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe drejtuesit të prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Shkallës së Parë. Këtu ka një mospërputhje që unë kam përshtypjen që ne duhet ta saktësojmë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Në qoftë se ka diçka që mund ta shikoni më mbrapa, mirë, po ashtu mbetet siç është.

Artan Hoxha – A ka procedurë që t’i kthehemi asaj 13-ës, ju lutem?

Fatmir Xhafaj – Jo, jo. Vazhdojmë, pastaj përpara votimit në tërësi.

Neni 16. Prokuroria e posaçme.

Ulsi Manja – Në nenin 16, në paragrafin e parë ne propozojmë një riformulim për fjalët “autoriteti përgjegjës”. Pra, “Prokuroria e Posaçme është autoriteti përgjegjës” dhe vazhdimin “për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq. Shtohen fjalët “autoriteti përgjegjës”.

Vasilika Hysi – Pse i keni hequr fjalët “sipas parashikimeve të bëra në ligj”, sepse duhen?

Fatmir Xhafaj – Po, do të jenë. Te pika 1 do të shtohen fjalët “autoriteti përgjegjës për ushtrimin e ndjekjes penale” e të tjera.

Ulsi Manja - Në pikën 2 hiqet fjala “e veçantë” dhe zëvendësohet me fjalën “të posaçme”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Duhet të jenë edhe fjalët “sipas parashikimeve të bëra me ligj”.

Fatmir Xhafaj – Po.

Artan Hoxha – Pse duhen fjalët “autoritet përgjegjës”? “Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën për veprë penale...” është, nuk ka pse të jetë “autoritet përgjegjës”. Nuk janë terma tipike ligjore, sepse këtu thuhet juridiksioni i kësaj, nuk ke pse thua “autoritet përgjegjës”, do të thosha unë, çështje fjalësh është.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 17 “Prokurorët pranë Gjykatave të Apelit”, dakord?

Artan Hoxha – Po.

Fatmir Xhafaj – Neni 18 “Prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë”, dakord?

Artan Hoxha – Po.

Fatmir Xhafaj – Neni 19 “Numri i përgjithshëm i prokurorëve”?

Artan Hoxha – Te neni 18, në vend të fjalëve “ushtrohen nga prokuroritë e Shkallës së Parë”, duhet thënë: “ushtrohen nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë”.

Vasilika Hysi – Te paragrafi i parë?

Artan Hoxha – “Funksionet e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë”.

Fatmir Xhafaj – Te neni 18?

Artan Hoxha – Po.

Vasilika Hysi – Kam edhe unë diçka.

Fatmir Xhafaj – Te neni 18?

Vasilika Hysi – Po, për paragrafin e ...

Ulsi Manja – Është për nenin 19.

Vasilika Hysi – Më falni, e kam për nenin 19, kërkuj ndjesë.

Fatmir Xhafaj – Neni 18 kalon me ndryshimin që u propozua.

Neni 19 “Numri i përgjithshëm i prokurorëve”.

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Unë kam marrë shkas nga neni 19, jo për përmbajtjen, por për konceptin e përdorur në nenet 19 dhe 20, që lidhet me rekomandimet e Këshillit të Ministrave.

Në nenin 22 është: “nënrekomandimet e Këshillit të Ministrave, përkatësisht në luftën kundër kriminalitetit” e të tjera. Te formulimet, të cilat e rrëzojnë këtë koncept, që Këshilli i Ministrave jep nënrekomandimet përkatëse, është për t’u ndalur, sepse Këshilli i Ministrave ka ministrin e Drejtësisë si instrument të komunikimit dhe të kontrollit.

Në një ligj, mundësia e së drejtës së kontrollit të jashtëm, inspektimit nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit apo funksionet bien, unë nuk e kuptoj, nuk do ta kuptoja edhe po të isha anëtar i qeverisë, se si Këshilli i Ministrave do ta ruajë urën e komunikimit, do të ketë mundësi të ndjekë dhe të monitorojë rekomandimet që jep, pasi është e qartë që jep rekomandime. Jemi dakord dhe me mirëkuptim të plotë që prokuroria do t'i zbatojë, por, si çdo detyrë, që duhet ndjekur dhe kontrolluar, kërkon instrumentin e saj.

Meqenëse këtu shfaqet që rekomandimet e Këshillit të Ministrave dhe nënrekomandimet e tij kanë vlerë orientuese dhe përcaktuese, na duhet të rishikojmë në këtë dritë se cili është roli i instrumentit që ka qeveria natyrshëm, sepse, sigurisht, nuk është detyrë e ministrit të Arsimit, Shëndetësisë apo Financave të merret me këtë punë. Në këtë pikë unë them se duhet të ndalojmë seriozisht për ta pasur vërtet atë ndërthurje të punëve ndërmjet ekzekutivit, i cili ka një rol shumë të madh, edhe si përfaqësues i publikut, që e kemi thënë dhe është shfaqur edhe në komunikimet me shkrim që janë bërë me *think tank*-un, ndonëse ligji nuk ka reflektim për këto.

Meqenëse po e diskutojmë, duhet të ndalemi dhe të gjejmë përcaktimet konkrete, pasi nuk ka asnjë institucion, cilido qoftë përcaktimi i tij, që të ketë mirëbesim absolut se i kryen detyrat në mënyrë perfekte. Të gjitha institucionet e shtetit shqiptar, ekzekutive apo gjyqësore, prokurori apo çfarëdo qofshin, funksionojnë mbi parimin e kontrollit reciprok. Kur ky kontroll apo monitorim sistematik brenda ligjit nuk ekziston, atëherë mund të sigurojmë pavarësi në dukje, të cilat janë me të gjitha premisat për një abuzivitet të jashtëzakonshëm dhe në vend që të ndërtojmë institucione të ekuilibruara, ndërtojmë institucione të çekuilibruara që, në emër të lirisë së tyre pafund, të moskontrollit dhe të mosmonitorimit bëhen nga zgjidhës problemi, në një problem të madh të shtetit. Po e them edhe një herë tjetër, nuk besoj tek asnjëri në shtetin modern pluralist që ekziston, i cili e ka monopolin e besimit absolut, të gjithë janë në një kontroll reciprok. Në këtë pikë, meqenëse merret ky koncept dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë pikë të caktuar të nenit, mendoj se nën dritën e përcaktimeve që ndodhin në nene respektive, të përcaktojmë edhe se si realisht mund të ndërtohen këto ura komunikimi dhe si mund t'i vendosim në ligj.

Fatmir Xhafaj – Keni gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Në fakt, zoti kryetar, çështja që ngre zoti Vasili lidhet me orientimet e politikës penale. Kjo është kompetencë e Këshillit të Ministrave dhe rregullohet edhe në nenin 68 të projektligjit. Instrumenti është ministri i Drejtësisë, i cili, sipas nenin 68 të projektligjit, rekomandimet e Këshillit të Ministrave ua bën të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve, por me Kushtetutë, me standard, ai që përcakton orientimet

e politikës penale është Këshilli i Ministrave, që ka në varësi Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mirëqenies, Ministrinë e Drejtësisë, sepse, kur përcakton orientimet e politikës penale, nuk ke parasysh vetëm punën e prokurorisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe financat, shërbimet dhe rolin e një sërë institucioneve të tjera.

Shqetësimi i zotit Vasili ka gjetur rregullim shumë mirë në nenin 68, ku përcaktohet qartë raporti midis Këshillit të Ministrave, prokurorëve dhe ministrit të Drejtësisë. Në rastin konkret, te neni 19 flitet për numrin e përgjithshëm të prokurorëve. Numri i përgjithshëm i prokurorëve duhet të ketë parasysh gjendjen e kriminalitetit, por edhe prioritetet e politikës penale në një periudhë të caktuar kohore 5-vjeçare ose për këtë vit, të cilat, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë u bëhen publike institucioneve brenda një kohe të caktuar, që ligji e përcakton shumë qartë. Por përcaktimi i këtij numri nuk mund të bëhet duke injoruar Këshillin e Ministrave që ka brenda edhe Ministrinë e Financave apo edhe institucionet të tjera.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por cila është ideja juaj, sepse nuk e kuptova?

Petrit Vasili – Fatmir, më fal!

Unë nuk e kuptova proceduralisht. Këto sugjerime nuk ia drejtoj Vasilikës, por relatorëve dhe personave që kanë hartuar ligjin.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Petrit Vasili - Pavarësisht nga leximi integral i ligjit, unë nuk kam bindje absolutisht të tilla, siç i ka Vasilika, por nuk dua të debatoj dhe të komentoj me të, sepse hartuesit janë të tjerë dhe përgjegjësinë për mundësitë e reflektimit ose jo e ka relatori.

Për sa i takon leximit të ligjit në mënyrë integrale, këto janë konkluzionet, të cilat unë i kam bindje të miat. Mund të ndajmë bindje të ndryshme, sigurisht, por nuk kam ndër mend të ndryshoj bindjet e mia nga komentet. Nga relatori dhe nga propozuesit i dëgjoj me kënaqësi, shikoj edhe çfarë mund të reflektoj për to.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Unë besoj se shqetësimi juaj do të jetë në vëmendjen e relatorit dhe të hartuesve të projektligjit për ta parë në dispozitat përkatëse.

Paraprakisht po them se unë ndaj në parim të njëjtin koncept me ju. E kam thënë edhe gatë diskutimit që është bërë për këto çështje, që ministri i Drejtësinë, si përfaqësues i ekzekutivit, duhet të ketë një rol më proaktiv në sistem për të garantuar balancën ndërmjet pushteteve dhe për ta ndihmuar këtë balancë që të ekzistojë dhe të veprojë, por, njëkohësisht, edhe si avokat i interesave të sistemit në ekzekutiv. Pra, ka rol të dyfishtë.

Në këtë koncept, kam mbajtur shënimet e mia përkatëse për të reflektuar aty ku mendoj se është vendi, ashtu sikundër do të jetë vendi për të reflektuar kur të diskutojmë për inspektimin dhe për çështje të tjera që lidhen me raportin ndërmjet ministrisë dhe sistemit në tërësi. Por unë i përmbahem pikëpamjes që në mënyrë të veçantë me sistemin e drejtësisë penale, për shkak të detyrimit kushtetues që ka ekzekutivi në luftën kundër kriminalitetit, duhet të ketë më shumë pikëprerje pa imponime ndërmjet ekzekutivit dhe prokurorisë, sepse kanë qëllim të përbashkët, kanë struktura që bashkëveprojnë, struktura që koordinojnë, që mbështesin njëra-tjetrën dhe, nëse nuk do të gjejmë pika të përbashkëta që t'i bëjnë efektive këto marrëdhëniet, mund të dështojë qëllimi madhor që kemi: lufta kundër kriminalitetit. Prandaj do të duhet të jemi shumë të kujdesshëm, natyrisht pa cenuar pavarësinë e sistemit, por duke e ruajtur me kujdes këtë ekuilibër. Pavarësisht ndërhyrjes së zotit Vasili, që përkon me preokupimin tim, këtu është një shënim që e kisha vënë për leximin e tekstit për përgatitje dhe përmbledhje. Në nenet vijuese do të përpiqemi që, për sa kohë që unë e propozoj, duhet të ketë një konsultim me ministrin për numrin e përgjithshëm me qeverinë. Pse? Çfarë ndodh sot? Ka 3-4 vjet që prokurori i Përgjithshëm në detyrë vjen çdo vit dhe thotë: Më duhen prokurorë e të tjera dhe, e para, pa argumente për gjërat që nuk përputhen dhe ne i kemi kthyer mbrapsht me politikat e qeverisë. Ndërkohë, ministri i Drejtësisë ka dy vjet rresht që mban një politikë të caktuar, këtu vijnë kërkesat për një politikë tjetër. Pra, është e domosdoshme që Kuvendi, kur ta marrë në shqyrtim, sepse nuk është fundor prokurori i Përgjithshëm, është organi i Kuvendit, do ta pyesë prokurorin e Përgjithshëm: je konsultuar? Mund të ketë të drejtë prokurori i Përgjithshëm, do të vendosë sipas prokurorit të Përgjithshëm, por, nëse nuk është konsultuar, do të pyesë edhe qeverinë: kjo që keni dhënë ju, a përputhet me politikën që kemi si shtet? Prandaj është shumë e rëndësishme të kemi një konsultim dhe është Kuvendi që vendos se cili nga këta ka të drejtë, dhe më pas ka edhe çështje të tjera.

Jeni dakord, zoti Hoxha?

Artan Hoxha – Dakord, por unë them se pak a shumë është e parashikuar në dispozitat që vijnë më pas, por mund ta themi edhe në mënyrë specifike.

Fatmir Xhafaj – Këtu flasim se si caktohet numri i përgjithshëm dhe ai duhet ta ketë një konsultim. Kur të arrijmë tek ajo, do të flasim.

Po ju them se çfarë ndodh sot me Prokurorinë e Përgjithshme. Cila është ironia? Ai e kërkon çdo vit këtë gjë, pretendon çdo vit se ka njerëz dhe çon në Shkollën e Magjistraturës vetëm 5 vetë. Prokuroria është mbushur me oficerë. Në 4 vjet rresht, kërkesa për Shkollë Magjistrature është për 5 ose 7 veta, ndërkohë kërkesa çdo vit është për 30 prokurorë. Kur e

ke ditur se duhen 30-40 prokurorë, ministria është një lloj balance, është një lloj filtri, është një lloj kontrolli dhe i thotë: hajde të bëjmë një studim bashkë. Duhen 40? Atëherë na duhet të rrisim numrin e atyre që duhet të përgatisim në shkollë për këtë gjë dhe më pas mund të jenë edhe prokurorët e specializuar e të tjera.

Prandaj, është e domosdoshme të ketë një ... Më pas është ministri që e koordinon me Ministrinë e Financave, sepse ai është përfaqësues qeverie, nuk është në emrin e tij personal.

Artan Hoxha – Unë e kuptova shqetësimin, por po e mbajmë si shënim.

Fatmir Xhafaj – Dakord, e rëndësishme është të reflektoni.

Artan Hoxha – Mendoj se ka rregullim rrugës, por, nëse duam ta themi në mënyrë

...

Fatmir Xhafaj – Do ta themi në mënyrë specifike numrin e përgjithshëm. E kemi shqetësim të lindur.

Artan Hoxha – Kur të vijmë te dispozita e posaçme, sepse këtu e kemi thënë Këshillin e Ministrave si ...

Fatmir Xhafaj – Përveç asaj.

Artan Hoxha – Se si përcaktohen numri dhe buxheti, kemi dispozita më pas, sepse do të jenë afatshkurtër dhe afatmesëm.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zoti Manja, urdhëroni!

Ulsi Manja – Po të shikosh frymën e ligjit, pikat e kontaktit për nenin 19 bëjnë fjalë për një kompetencë të prokurorit të Përgjithshëm, sepse përcaktimi i numrit i është lënë kompetencë kushtetuese prokurorit të Përgjithshëm, është këshilli dhe, sigurisht, edhe qeveria. Mua më duket se projektligji, në nenet që vijnë në vazhdim, ka bërë të njëjtin parashikim.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por Këshillin nuk e ke fare këtu.

Ulsi Manja - Pra, marrëdhëniet me ministrin e Drejtësisë janë përcaktuar në mënyrë eksplicite në nenin 73. Përderisa qeveria jep rekomandimet për luftë kundër kriminalitetit nëpërmjet ministrit të Drejtësisë dhe në nenin 73 është parashikuar detyrimi i ministrit të Drejtësisë për të mbrojtur buxhetin e prokurorisë në Këshillin e Ministrave, lë të kuptohet një bashkëpunim...

Fatmir Xhafaj – Pse të mos e themi në mënyrë eksplicite, që të ulen dhe të bashkëpunojnë për këtë gjë, sepse është e lehtë të shtosh prokurorë?

Ulsi Manja – Nëse do të jetë nevoja, ta shikojmë në mënyrë eksplicite këtë formë bashkëpunimi.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Shikojeni dhe reflektojuni!

Vasilika Hysi – Kam edhe unë diçka, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Ka një model te ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ku i ngarkohet Këshillit të Lartë Gjyqësor përcaktimi i numrit të gjyqtarëve.

Fatmir Xhafaj – Po, edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet përfshirë këtu.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, unë kam diçka për...

Artan Hoxha – Ajo është e rregulluar atje.

Vasilika Hysi – Po, por te ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, kur flasim për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve dhe në tërësi nëpër degë, thuhet se konsultohet me ministrin e Financave, me Këshillin e Lartë Gjyqësor e të tjera.

Kam edhe një propozim tjetër për riformulim të teknikës legjislative. Në paragrafin e tretë të këtij neni sugjeroj të lexohet: prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, jo saktë si më sipër dhe, gjithashtu, fjalët “të mbajmë në konsideratë”, të bëhen “të mbajmë parasysh”.

Te pika 4, pasi të reflektoni edhe këtë diskutim, kur thuhet “numri i përgjithshëm i prokurorëve” e të tjera, “të përcaktohet duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit të bëra të paktën gjatë 3 vjetëve të fundit”, jo “gjatë të paktën 3 vjetëve të fundit”. Domethënë, të kemi një riformulim më të mirë nga teknika legjislative.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Matilda, po mbani shënime ju?

Artan Hoxha – Besoj se zbardhen këto.

Fatmir Xhafaj - Zbardhja do të bëhet më vonë.

Dakord për nenin 19 me sugjerime.

Neni 20 “Numri i prokurorëve për çdo prokurori”.

Ulsi Manja – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Keni gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Për saktësim të referencave, në paragrafin e tretë duhet thënë se duhen marrë parasysh objektivat e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 19 të këtij ligji,

pasi numri i përgjithshëm i prokurorëve, objektivat përcaktohen në paragrafin 3 dhe në nenin 4. Nenet 1 dhe 2 kanë të bëjnë me kompetencat e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe të prokurorit të Përgjithshëm.

Fatmir Xhafaj – Ku e ke? Te 3-shi?

Vasilika Hysi – Po, te 3-shi, referenca do të jetë te paragrafët 3 dhe 4 të nenit 19, dhe jo tek i gjithë neni, sepse objektivat përcaktohen aty.

Fatmir Xhafaj – Dakord, thuaje më mirë në këtë ligj dhe...

Vasilika Hysi – Jo, duhet përcaktuar në paragraf. Përderisa thuhet në nenin 19 të këtij ligji, duhet të thuhet: “në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 19 të këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 21 “Struktura e prokurorive”: “Sipas strukturës standardet miratohen nga prokurori”. Dakord.

Neni 22 “Seksionet e prokurorive”.

Ulsi Manja – Në paragrafin e parë të nenit 22 ne propozojmë një riformulim: “Në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, me vendim të mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve ngrihen seksione të përbëra nga jo më pak se 3 prokurorë. Ngritja e tyre bazohet në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin dhe intensitetin e veprave penale, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Artan Hoxha – Domethënë “me jo më pak”, në vend të “nga të paktën”.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, a mund t’i heqim fjalët “me vendim të mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve”, sepse nuk e kuptoj ç’punë ka mbledhja e përgjithshme e prokurorëve me seksionet? Ai është një organizim i brendshëm, në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve do të mblidhen prokurorët. Do të caktojmë seksione, apo jo? Po Këshillin e Lartë të Prokurorisë pse e kemi bërë ne pastaj?

Ai ia çon...

Artan Hoxha – Termi i mbledhjes...

Fatmir Xhafaj – Po ç’punë kanë prokurorët bien, apo nuk bien dakord ata të kenë seksion dhe, në qoftë se nuk bien dakord, ta hedhin në short.

Ata janë në punën e shtetit, se e keni bërë tani një çikë...

Artan Hoxha – Nëse më lejoni për një shpjegim.

Fatmir Xhafaj – Po.

Artan Hoxha – Ndoshta është...

Fatmir Xhafaj – Me vendim të mbledhjes...

Artan Hoxha – Nuk është fjala për mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve.

Fatmir Xhafaj – Të prokurorisë atje.

Artan Hoxha – Është fjala për mbledhjen e prokurorisë atje.

Fatmir Xhafaj – Mbledhja e përgjithshme nuk është organ vendimmarrës, është organ konsultativ. Ata kanë shoqatën e tyre, të venë te shoqata, se pastaj nuk bien dakord ata. Nuk duam thonë ata.

Po prokurori i Përgjithshëm për çfarë është këtu pastaj, po ky që ka sjellë rekomandimet për të luftuar kriminalitetin? Ne nuk duam që të kemi seksione këtu se mirë i kemi, e bëj unë punën e seksionit.

Besoj se këtë me vendim të mbledhjes së përgjithshme...

Artan Hoxha – Ndoshta mund të thuhet ndryshe...

Fatmir Xhafaj – Ne jemi kundër mbledhjes së përgjithshme në parim, prandaj po e them, që të jetë vendimmarrëse.

Artan Hoxha – Kur të shkojmë te dispozita konkrete ta diskutojmë...

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër.

Artan Hoxha – Koncepti i mbledhjes së prokurorëve të secilës strukturë është futur si një koncept që prokurorët së bashku këshillojnë në Prokurorinë e Përgjithshme...

Fatmir Xhafaj – Është tjetër gjë si element demokratik, që ata të japin mendime, të raportojnë...

Artan Hoxha – Shqetësimet që ata kanë...

Fatmir Xhafaj – Është normale, të mblidhen sa më shpesh madje.

Artan Hoxha – Aty diskutojnë për problematikat e tjera dhe kjo është...

Fatmir Xhafaj – Unifikojnë praktikën, qëndrimet, unë dakord jam, por jo të marrin vendime se si do të funksionojë. Pastaj pse i vumë ne, ta bëjmë kukull prokurorin e Përgjithshëm, kukull prokurorin e rrethit, kukull Këshillin e Lartë, se vendosin këta të gjithë bashkë?

Artan Hoxha – Vetëm se nuk bëhet fjalë për mbledhje të përgjithshme të prokurorëve.

Fatmir Xhafaj – E di, e kuptoj shumë mirë mbledhjen e përgjithshme të një prokurori, akoma më keq mbledhje kolektivi.

Artan Hoxha – Mbledhje kolektivi që thotë...

Fatmir Xhafaj – Si? Më vjen keq.

Artan Hoxha – Në çdo rast kur të vijmë tek ajo, këtu jemi.

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër.

Artan Hoxha – Edhe ne vetë jemi në atë diskutimin tonë, por eksperiencat e vendeve të tjera e njohin këtë, prandaj është futur si koncept. Edhe ne dikur e kemi pasur takimin e prokurorëve, të cilët...

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, nuk e përjashtoj, por varet për çfarë. Jo për të marrë vendime se si funksionoj unë, që të më lidhësh këmbët më shumë.

Artan Hoxha – Nuk e kam Korën këtu që ta mbrojë fort këtë, sepse unë nuk jam ndonjë mbrojtës i fortë i kësaj, gjithsesi vini një shënim...

Fatmir Xhafaj – Me gjithë respektin që kam për Korën dhe për gjithë të tjerët, kur diskutojmë këtu...

Artan Hoxha – Modeli kroat është këtu brenda...

Fatmir Xhafaj – Modeli kroat ka shumë gjëra të mira dhe, po ta kishim zbatuar, nuk do t'i kishim vënë disa gjëra, përndryshe, Shqipëria nuk është Kroacia dhe Kroacia nuk është Shqipëria për të gjitha gjërat. Modeli standardi është.

Artan Hoxha – Atëherë më kthe mbrapsht te dega e prokurorisë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, e diskutojmë edhe atë.

Artan Hoxha – Ajo është thelbësore.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Artan Hoxha – Për mua është e gabuar tërësisht.

Fatmir Xhafaj – Nuk është e gabuar dhe ta them unë pse, meqenëse kërkon që të bëjmë debat dhe ta kthejmë në debat. Nuk është e gabuar, sepse ai që është në Sarandë, në qoftë se do të bëhet degë, duhet të vejë prokurori për të bërë 5 veprime atje që të mos vijë ai për një gjë fare të rëndomtë këtu, pra të bëjë kilometra të tëra ai qytetari atje.

Artan Hoxha – Te prokurori do të shkojnë kudo që të jetë prokurori, ndërsa në gjykatë është ndryshe.

Fatmir Xhafaj – Jo, dakord, por edhe në gjykatë, edhe te prokurori. Do të shkojë ta pyesë për çështje të vogla, për çështje që...

Artan Hoxha – Zoti kryetar, gjykata ka...

Fatmir Xhafaj – U kap ai me pije në makinë dhe duhet të...

Artan Hoxha – Ku do të shkojë? Do të shkojë përpara prokurorit, të kërkojë drejtësi te prokurori...

Fatmir Xhafaj – Prandaj, do të rrijë një prokuror dhe një gjyqtar aty që të mos shkojë nga Saranda në Vlorë, duke bërë kilometra të tëra.

Patjetër, sepse është edhe aksesi në drejtësi. Po aksesi në drejtësi?

Artan Hoxha – Nuk është akses në drejtësi prokurori. Unë e kuptoj që ju nuk e....

Shqipëria është 28 mijë kilometra katrorë, nga të cilat vetëm gjysma është e banueshme...

Fatmir Xhafaj – Unë e lashë të hapur atë pikë që ta diskutojmë përsëri, ky është pozicioni...

Artan Hoxha – Për efekt të ndjekjes penale...

Fatmir Xhafaj – Dakord, jemi te seksionet, profesor. Te formulimi që është sjellë, a keni ndonjë gjë tjetër?

Artan Hoxha – Te seksionet do të vëmë këtë shënimin për mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve, që ta shikojmë në dispozitën përkatëse.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Faleminderit!

Zoti Smibert!

A ju dëgjova të gjithëve? E lashë për në fund zotin Smibert që ta përmbyllë.

Zoti Smibert!

Jon Smibert - (*flet anglisht*) Faleminderit!

Megjithëse nuk më pëlqen që t'i rikthehem përsëri, por në nenin 20, ashtu si e lexoj unë, të cilin e kam lexuar shpeshherë, nuk jam i sigurt se kush e merr në fakt vendimin për numrin e prokurorëve në prokurori në këtë seksion. Këtu thuhet që së paku 5 vjet prokurori i Përgjithshëm vlerëson numrin e prokurorëve për çdo prokurori dhe ai mund të ripërcaktojë numrin e tyre, pasi ka marrë mendimin e drejtuesve të prokurorive përkatëse, por unë nuk e di se kush e merr këtë vendim për sa i përket numrit të prokurorëve të veçantë. Unë prisja që do të ishte një këshill i lartë i prokurorisë që do ta merrte këtë vendim, por kjo nuk del qartë në këtë vend këtu.

Fatmir Xhafaj – Edhe unë ndaj të njëjtin shqetësim, prandaj te neni 19 thashë që duhet të hyjë Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Pra, numri i çdo prokurorie duhet të jetë vendimmarrje e këshillit dhe jo vendimmarrje e mbledhjes së përgjithshme, prandaj e krijuam Këshillin e Lartë të Prokurorisë që është i mbledhur dhe punon *full time*, mblidhet herë pas here, nuk është fakultativ, është qeveria e sistemit dhe natyrisht prokurori i Përgjithshëm është njeriu ekzekutiv, një figurë e fortë që duhet të jetë, përjashtoj pjesën...

Artan Hoxha – Neni 19 thotë që propozon, nuk është ai që e përcakton.

Fatmir Xhafaj – E drejtë. Prandaj shkon te Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe ky këshill...

Artan Hoxha – Me atë që po shoh është ligji për Këshillin e Lartë të Prokurorisë...

Fatmir Xhafaj – Kjo duhet të parashikohet, jam dakord me këtë.

Artan Hoxha - E ka ligji këtë.

Fatmir Xhafaj - Neni 22, te seksionet.

Po, ke të drejtë, je partizane e çështjeve të të drejtave të njeriut.

Vasilika Hysi – Është çështje parimore, sepse në Kodin e Procedurës Penale e kemi përcaktuar që seksionet krijohen me dekret të Presidentit. Sot, seksionet e të miturve krijohen me dekret të Presidentit dhe në Kodin e Procedurës Penale, me aq sa unë kujtoj, e kemi në nenin 13. Po bëj një lidhje tani midis krijimit të degëve të prokurorisë dhe seksioneve të prokurorëve. Unë nuk jam dakord, sikurse edhe ju, madje ju mbështes që krijimi i seksioneve t'i lihet mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve. Unë jam që Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të jetë ai që duhet të përcaktojë llojet e seksioneve që do të krijohen, meqenëse ia kemi hequr të drejtën Presidentit. Të mos harrojmë që në gjykata për krijimin e seksioneve ne patëm një debat nëse do ta bënte Presidenti apo do ta bënte parlamenti, në qoftë se ju kujtohet, ndërsa këtu kemi kaluar te mbledhja.

Për mua çështja e dytë për të cilën e mora fjalën është pikërisht...

Fatmir Xhafaj – Të jemi korrektë, nuk kemi pasur...

Vasilika Hysi - Për krijimin e degëve?

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk e ka, të mos ta kalojmë më tej.

Vasilika Hysi – Sot, seksionet e të miturve krijohen me dekret të Presidentit. Të dy presidentët qoftë zoti Topi, qoftë zoti Moisiu e kanë dekretuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Le të rrimë te seksionet, që të mos bëjmë analogji.

Vasilika Hysi – Lidhur me seksionet, në formulimin e nenit 22 unë shoh dy probleme:

E para, që krijimi i seksioneve nuk bëhet për kategori të caktuara veprash penale kur është e nevojshme, sepse thuhet: “Kur është e mundur dhe e nevojshme”. Ndoshta prokurorët mendojnë që nuk është e mundur.

Fatmir Xhafaj – Mirë, e lamë te këshilli.

Vasilika Hysi – E dyta, ne u kemi kaluar të paktën degëve të prokurorisë apo edhe degëve të gjykatave çështje të rëndësisë së vogël dhe, kur e kam pyetur zonjën Agnes se cilat do të jenë kompetencat e këtyre degëve, ajo më ka thënë se do të jenë edhe çështjet penale, çështjet e vogla që gjykohen me një gjyqtar ose për të cilat parashikohet mundësia e ndërmjetësimit, zgjidhja e çështjeve në rrugë jashtëgjyqësore. Në këtë kuadër, në rast se degët e prokurorisë do të kenë në kompetencë kundërvajtjet penale, çështjet e vogla ose veprat penale që ndiqen me ankim, për të cilat mund të bëhet ndërmjetësimi dhe subjekt i veprave

penale do të jetë i mituri, ne do të jemi të detyruar të mbajmë në konsideratë Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, por njëkohësisht edhe rregullimet e reja që sjell Kodi për Fëmijët. Prandaj, do t'u lutesha ekspertëve, që kanë punuar, që në këtë kuadër të shikojnë rregullimet ose detyrimet që përcakton Kodi i Fëmijëve, i cili tashmë është në diskutim, pra ka mbaruar...

Fatmir Xhafaj – Si do ta shikojmë këtu, Vasilika, të lutem, që të mos bëjmë diskutime...

Vasilika Hysi – Një minutë, ta mbaroj.

Fatmir Xhafaj – Mirë pra, të mos bëjmë diskutime për gjëra që nuk kanë lidhje

Vasilika Hysi – Ne seksionet e veçanta, zoti kryetar, nuk mund t'i krijojmë për kategori të caktuara veprash penale, sipas llojit të veprës dhe fjalës “intensitet”. Nuk është intensitet, por është shkalla e përhapjes së tyre, dinamika e tyre, sepse fjalën “intensitet” nuk e kemi. Por ne do ta bëjmë për një kategori të caktuar veprash penale që do të themi për kundërvajtjet ose për subjektet që është i mituri, dhe në të gjitha vendet europiane, si edhe modeli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka gjykata të të miturve, ka gjyqtarë të profilizuar për ta, dhe nuk mund të vazhdojë që prokurorë që sot merren me krimin ekonomik, nesër....

Fatmir Xhafaj – Ne jemi një fshat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Vasilika Hysi – Më falni, Amerika feston 120 vjetorin e Gjykatës së të Miturve, ne të paktën atë praktikë që kemi, si edhe seksionet e të miturve nuk duhet t'i prishim.

Artan Hoxha - Po kush ka thënë që po i prishim?

Vasilika Hysi – Nuk rregullohen, sepse ka dy gjëra, zoti Hoxha: ju vini si kusht “nëse është e mundur”, dhe e dyta...

Fatmir Xhafaj – Nëse nuk është e mundur, si të bëjë seksion ai me 5 prokurorë?

Vasilika Hysi - Atëherë, si do ta zgjidhim problemin nëpër degë?

Fatmir Xhafaj – Çfarë do të bëjmë? Do të caktojmë vetëm një prokuror që të ketë vetëm një çështje në 10 vjet?

Vasilika Hysi - Këtu mund të shikojmë një paragraf, duke e përshtatur, duke pasur parasysh edhe rregullimet që bën Kodi i Fëmijëve, drafti që është komentuar...

Artan Hoxha – Është Kodi për Procedurën Penale në vetvete, jo vetëm ai.

Vasilika Hysi – Kemi edhe një kod të veçantë për të miturit, por nuk e di sa është mbajtur parasysh.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, te kompetencat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, edhe ju si relatore, edhe ne, do të jemi të vëmendshëm që, kur të vijë ligji përkatës, te kompetencat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të vendosim që është detyrim i Këshillit të

Lartë të Prokurorisë të përcaktojë krijimin e seksioneve të specializuara sipas nevojës dhe mundësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ulsi Manja - Çështja është parimore në këtë pikë. Gjithë diskutimi është a do të ruajmë për prokurorinë që ofron një shërbim të ndjekjes penale dhe të hetimeve parapake pranë degëve, apo nuk do të ruajnë ndryshe nga gjykatat, sepse, nëse do të kemi shërbimin e prokurorisë pranë degëve të gjykatave, është i pamundur specializimi sipas seksioni. Një prokurori mëmë mund të ketë 5-6 prokurorë. Po ju marr si shembull prokurorinë e Dibrës me Bulqizën. Sot, shërbimi i prokurorisë, por edhe i gjykatave, është në Dibër, ndërkohë që Bulqiza është bashki më vete. Në rast se do të kemi degë të gjykatës në Bulqizë, pyetja që shtrohet është: shërbimi i prokurorisë kudo që të ndodhë vepra penale dhe kudo që ta kërkojë gjykata, prokuroria është e detyruar të ofrojë shërbimin që kërkohet. Problemi është a do të kemi pranë këtyre degëve të përhershme ose të përkohshme të gjykatave degë të prokurorisë, apo do t'i qëndrojmë konceptit të shërbimit të prokurorisë? Nëse do t'i qëndrojmë konceptit të shërbimit të prokurorisë pranë gjykatës, koncepti i degës së prokurorisë pranë degës së gjykatës nuk ka kuptim. Pra, çështja e seksioneve duhet parë në raport me degën. Unë them që ta diskutojmë pak më gjerë kur të vijë koha në nenet e mëvonshme, sepse kjo ha diskutim.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Zoti Smibert ka kërkuar fjalën.

Zoti Smibert – *(flet anglisht)* Po reflektoj për të gjitha çështjet që ju keni ngritur për sa i përket pritshmërisë së komunitetit ndërkombëtar. Ndodh shpesh që si gjykata e specializuar, si prokuroria e specializuar, të merren me veprat për të miturit. Kjo nuk është pritshmëri normale, por një normë, e cila gjendet kudo. Për një sektor duhet të ketë 3 prokurorë dhe shqetësimi është se, nëse do të jetë nevoja që një person të merret me një çështje të caktuar, atëherë nuk mund ta specializosh atë person dhe zyrat më të vogla, mund të kenë nevojë për prokurori dhe prokurorë të specializuar për çështjet e të miturve apo për çështje të krimit ekonomik. Vendet e vogla nuk mund t'ia dalin që të kenë një sektor të vogël me vetëm tre prokurorë dhe për këtë arsye mund të kufizohen për të pasur zyra më të mëdha të prokurorisë.

Fatmir Xhafaj - Biem dakord. Po, urdhëroni.

Arben Rakipi - Më tepër për të mbrojtur çështjen e seksioneve dhe të mbledhjes së përgjithshme, sepse gjithë ky diskutim vjen nga praktika dhe zoti Manja, duke qenë njeri i praktikës, e vlerëson në këtë pikëpamje, nëse duhet apo jo seksioni, sepse ka parasysh numrin e prokurorëve e kështu me radhë. Meqenëse kjo është çështje terreni, që ka nevojë për një bazë shumë të lartë praktikiteti, është ftuar në mbledhjen e përgjithshme për të vendosur. Këto janë shqetësime të përditshme që i vijnë titullarit nga praktika e ditës, bëhet fjalë për ato

prokurori që kanë një numër relativisht të madh prokurorësh dhe prej titullarit shihet e nevojshme që prokurorët t'i stabilizojë nëpër seksione sipas prirjes së tyre, sipas nevojës që ka prokuroria etj. Kjo është një çështje aq praktike, aq e terrenit, saqë është thirrur mbledhja e përgjithshme për të vendosur, jo se ka nevojë për ndonjë studim të sofistikuar që Këshilli i Lartë i Prokurorisë të merret me çfarë ndodh në Sarandë me specializimin e prokurorëve, kaq i thjeshtë është problemi.

Artan Hoxha - Dhe një gjë, që nuk duhet ngatërruar me seksionet e gjykatave, është veprimtaria operative brenda strukturës.

Ulsi Manja – Në nenin 23, paragrafi i parë, gërma “a”, ne propozojmë një riformulim.....

(Mungesë audio)

Fatmir Xhafaj – Do të fillojmë nesër në orën 10 dhe do të vazhdojmë me nenin 23 dhe në vijim, pra me dy projektligjet që kemi sot.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë